



PLANI SOCIAL, BASHKIA BERAT

2027-2030

05 GUSHT 2026



Leave
No One
Behind

United Nations Development Programme
United Nations House

"Skenderbej" Street, Gurten Building, 2nd Floor, Tirana, Albania
Tel.: +355 (4) 2250 205, 2250 224, 2250 234

Përgatitja e Planit Social të Bashkisë Berat u mundësua nga mbështetja e Programit “Leave No One Behind” i Kombeve të Bashkuara. Ky program është i angazhuar për të mbështetur reformën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Shqipëri në përgjigje të përpjekjeve të qeverisë shqiptare për të mundësuar përfshirjen sociale të grupeve në nevojë. Në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë qendror programi LNB po mbështet Bashkitë për të zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar Planet Sociale Lokale. Ligji nr. 121/2016 “Mbi shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ngarkon Bashkitë me detyrën e përgatitjes së këtyre Planeve bazuar në nevojat e identifikuara për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e tyre.

Përmbajtja

Lista e tabelave dhe figurave	3
Shkurtesa	4
1.Hyrje	5
2. Vlerësimi i arritjeve të Planit Social, 2024-2027	6
3. Kuadri llogjik i Planit të Përkujdesit Social, 2027-2030.....	8
3.1. Baza legjislative	8
3.1 Vizioni	10
3.2 Misioni.....	10
3.3 Vlerat dhe parimet udhërrëfyese	10
3.3.1 Vlerat	10
3.3.2. Parimet udhëheqëse	10
3.3.3 Procesi i hartimit të Planit Social 2027-2030.....	11
3.3.4 Analiza SWOT	13
4. Analiza e situatës.....	14
4.1. Të dhëna demografike	14
4.2. Grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi.....	16
4.2.1. Përfituesit e Ndihmës ekonomike	16
4.2.2.Aftësia e kufizuar.....	18
4.2.3. Punëkërkuesit e papunë.....	19
4.2.4. Fëmijët e përjashtuar ose në rrezik përjashtimi.....	20
4.2.5. Gra në situatë kritike	20
4.2.6.Të moshuar në situatë kritike.....	21
4.2.7.Minoritetet etnike.....	21

4.3. Profili i shërbimeve që ofrohen në bashkinë Berat	22
4.3.1. Shërbimet dhe institucionet e përkujdesit shoqëror	22
4.3.2. Përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror	23
4.3. 3 Burimet njerëzore, ofruese të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.....	24
4.4. Përmbledhje: Grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi	25
5. Vlerësimi cilësor I nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror	27
6. Fushat strategjike në të cilat duhet të ndërhyjë bashkia nëpërmjet Planit Social 2027-2030	31
6.1. Prioritetet, qëllimi dhe objektivat	31
6.2.Kosto e përgjithshme e Planit të Shërbimeve Sociale, 2027-2030	32
7. Plani i veprimit.....	33
8. Plani I Integruar I Monitorimit dhe Vlerësimit.....	48
9. Vlerësimi i mundësisë së mbulimit të kostos të planit social 2027-2030	50
9.1. Analiza e shpenzimeve për mbrojtjen sociale në raport me të ardhurat e veta të bashkisë.....	50
9.2.Analiza e mundësive për financimin e planit social, sipas PBA 2027-2030.	53
9.3.Rekomandime për mirë planifikimin e shpenzimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë Berat.....	54
Shtojcë 1	55
Shtojcë 2	55
Shtojcë 3	55

Lista e tabelave dhe figurave

Tabela 1: Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimit mbështetur në të dhënat e Regjistrit të Gjëndjes Civile

Tabela 2: Popullsia sipas grupmoshave

Tabela 3: Individë përfitues të ndihmës ekonomike në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë si edhe me numrin e aplikantëve të NE, në përqindje

Tabela 4: Përfituesit e ndihmës ekonomike, sipas përbërjes.

Tabela 5: Individët me AK, sipas përbërjes dhe përfitimeve monetare.

Tabela 6: Të dhëna mbi punëkërkesit e papunë, numër dhe përqindje

Tabela 7: Fëmijë në situatë kritike dhe në nevojë për mbrojtje.

Tabela 8: Numri i grave në situatë kritike

Tabela 9: Të moshuarit në situatë kritike.

Tabela 10: Shërbimet e përkujdesit shoqëror

Tabela 11: Përfitues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror

Tabela 12: Individë në situatë kritike dhe në nevojë për shërbime

Tabela 13: Përmbledhje e individëve në nevojë për shërbime të identifikuara në raport me numrin e popullsisë

Tabela 14: Grupet më të përjashtuara dhe nevojat më kritike të tyre.

Tabela 15: Shërbimet më të nevojshme në bashkinë Berat.

Tabela 16. Individët në nevojë dhe tipet e shërbimeve të mundshme sipas shportës së shërbimeve

Tabela 17: Kosto e përgjithshme e Planit të Shërbimeve Sociale

Tabela 18: Të ardhurat e bashkisë Berat (lekë)

Tabela 19: Buxheti i mbrojtjes dhe kujdesit shoqëror, 2023-2026 (lekë).

Viti 2026 është shifra vetëm 6mujo rin e parë.

Tabela 20: Projektet e mbështetura nga burime të tjera në bashkinë Berat.

Tabela 21: Shpenzimet e përgjithshme vetëm për mbrojtjen shoqërore (mijë lekë)

Tabela 22: Shpenzimet e kujdesit shoqëror kundrejt totalit të ardhurave, lekë, 2023-2026 (Viti 2026 është shifra 6 mujo rit parë)

Tabela 23: Shpenzimet e bashkisë për Programin e Mbrojtjes Sociale, sipas PBA 2027-2030 (mijë lekë)

Tabela 24: Kosto e Planit Social përballë të Ardhurave të bashkisë (mijë lekë).

Figura 1: Shpërndarja e Popullsisë sipas njësive administrative të bashkisë në %

Figura 2: Popullsia sipas grup moshave

Figura 3: Përqindja e Individëve me AK sipas njësive administrative.

Figura 4: Shërbimet e përkujdesit shoqëror 2026/2023

Figura 5: Tregues jo të drejtëpëtdrejtë të nevojës për shërbime

Figura 6: Treguesi Përfitues/Staf, raport

Shkurtesa

AK Aftësia e kufizuar

LNB Leave no one behind (Askush të mos mbetet pas)

LSMS Studimi mbi matjen e nivelit të jetesës

PAK Pagesa e aftësisë së kufizuar

PBA Plan Buxheti Afatmesëm

PK Pagesa e kujdestarisë

1.Hyrje

Bashkia Berat ndodhet në pjesën jug-qendrore të Shqipërisë dhe është një nga bashkitë me vlerat më të spikatura historike, kulturore dhe turistike të vendit. Ajo shtrihet përgjatë lumit Osum dhe përfshin qytetin e Beratit si edhe njësitë administrative Velabisht, Otllak, Sinjë dhe Rroshnik. Pozita e favorshme gjeografike, relievi i larmishëm dhe tokat pjellore krijojnë kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, agroturizmit dhe aktiviteteve të tjera ekonomike.

Berati është një nga qytetet më të vjetra të banuara në Shqipëri, me një histori mbi 2.400-vjeçare. Qyteti është pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe njihet për kalanë, arkitekturën karakteristike, objektet e kultit dhe pasurinë e tij kulturore, duke përbërë një nga destinacionet kryesore të turizmit kulturor në vend.

Ekonomia e bashkisë mbështetet kryesisht në bujqësi, agro-përpunim, tregti, turizëm, shërbime dhe sipërmarrje të vogël e të mesme. Kultivimi i ullirit, vreshtaria, pemëtaria, blegtoria dhe prodhimi i verës përbëjnë sektorë të rëndësishëm ekonomikë, ndërsa zhvillimi i turizmit ka krijuar mundësi të reja për punësim dhe zhvillim lokal.

Nga pikëpamja sociale, Bashkia Berat përballlet me sfida të tilla si plakja e popullsisë, emigracioni i të rinjve, pabarazitë ndërmjet zonave urbane dhe rurale, si dhe nevoja për zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për grupet në nevojë. Megjithatë, potenciali i madh kulturor, turistik dhe bujqësor, së bashku me investimet në infrastrukturë dhe zhvillimin ekonomik lokal, krijojnë baza të qëndrueshme për një zhvillim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të bashkisë.

Ky kontekst krijon nevojën për politika të integruara të zhvillimit social dhe ekonomik, të orientuara drejt përmirësimit të cilësisë së jetës, fuqizimit të kapitalit njerëzor dhe garantimit të aksesit të barabartë në shërbimet publike për të gjithë qytetarët.

Analiza e situatës së nevojave për shërbime të përkujdesit shoqëror e ndërmarrë për qëllim të këtij plani tregon se 6.824 persona ose 7.5% e popullsisë së bashkisë Berat janë në nevojë kritike për të paktën një shërbim të përkujdesit social. Individët mbi 21 vjeç me aftësi të kufizuara dhe invalidët e punës përbëjnë 41% të numrit të përgjithshëm të individëve të përjashtuar ose në rrezik kritik përjashtimi.

Me qëllim sigurimin e shërbimeve cilësore të përkujdesit shoqëror për individët dhe grupet më në nevojë kritike, Bashkia Berat prej vitit 2015 ka hartuar dhe zbatuar Planet e Kujdesit Social. Plani i Kujdesit Social, 2027-2030, i hartuar në bashkëpunim me UNDP dhe donatorë të tjerë, në kuadrin e programit “Askush të mos mbetet pas 3”, pason planet e mëparshme, por nuk është përsëritje e çështjeve, objektivave dhe aktiviteteve. Procesi gjithëpërfshirës për hartimin e planit të ri social mbështetet në:

- ✓ Analizën e arritjeve të planit të mëparshëm si edhe në identifikimin e objektivave të përealizuara.
- ✓ Përcaktimin e shkaqeve dhe faktorëve që penguan arritjen e objektivave.
- ✓ Vlerësimin e mundësive për përfshirjen e objektivave të përealizuara në planin e ri.

- ✓ Vlerësimin e mundësive për përfshirjen e aktorëve të rinj, jo tradicionalë në organizimin, financimin, mbështetjen dhe sigurimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Vlerësohet se 20% e nevojës për shërbime plotësohet në bashkinë Berat, ndërsa koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese është negativ, çfarë do të thotë se numri i atyre që përfitojnë shërbime është më i lartë se sa kapacitetet ekzistuese të shërbimeve¹. Planit i shërbimeve sociale të Bashkisë Berat, 2027-2030 mbështetet në ofrimin e një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë, si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato vendore, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

2. Vlerësimi i arritjeve të Planit Social, 2024-2027

Me qëllim formulimin e objektivave strategjike të përshtatshme dhe efektive, ekipi i bashkisë Berat, i ngarkuar me detyrën e hartimit të planit të Përkujdesit Social, vlerësoi shkallën e arritjes së objektivave të planit 2024-2027 nëpërmjet një metodologjie të përgatitur për këtë qëllim, të mbështetur në mbledhjen e informacioneve mbi bazën e një pyetëso individual si edhe dy formularëve shoqëruar (shih Shtojcë 1). Në këtë vlerësim u përfshi stafi teknik dhe politik i bashkisë, stafi i institucioneve të përkujdesit social, stafi i institucioneve nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si edhe grupe të tjera të interesit, bashkëpunëtorë të bashkisë.

Të dhënat u mblodhën gjatë gjysmës së dytë të muajit Maj 2026. Analiza e të dhënave tregoi se Qëllimi Strategjik i Planit 2024-2027 është realizuar në masën 65%, ndërsa buxheti i shpenzuar për arritjen e objektivave nuk është raportuar. **Riorganizimi i sistemit të mbrojtjes dhe kujdesit social, që çon në funksionimin efektiv të mekanizmit të identifikimit të rasteve, referimit dhe menaxhimit të tyre, veçanërisht për fëmijët në nevojë për mbrojtje, është arritja më thelbësore e planit ekzistues, ndërsa krijimi i shërbimeve të reja veçanërisht për individë me aftësi të kufizuar mbi 21 vjeç si edhe të moshuar, mbetet sfidat kryesore për periudhën 2027-2030.**

Planit Social 2024-2027 përbëhej nga katër objektiva strategjike, të cilët janë realizuar përkatësisht në masën 75%, 75%, 60% dhe 50%.

Objektiv strategjik 1 “Zhvillimi i kapaciteteve dhe përmirësimi i shërbimeve për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të qytetarëve.” përbëhej nga një objektivi, aktivitetet e të cilit rezultojnë të realizuara thuajse plotësisht. Vetëm një aktivitet, që synonte krijimin e sistemit publik të shërbimeve sociale, rezultoi i pa realizuar. Në realitet ky është një aktivitet tepër i përgjithshëm, i pamatshëm, shumë kompleks dhe i papërcaktuar as në kohë dhe as në hapësirë.

¹ Hartëzimi i shërbimeve të kujdesit social, 2025, https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2025-08/hartezimi_2025.pdf

Objektivi i dytë strategjik, “Konsolidim i mekanizmave ndërsektorial egzistues dhe zgjerim me mekanizma të rinj për identifikim dhe adresim efektiv të nevojave të grupeve vulnerabël”, përbëhet nga shtatë objektiva specifike. Ndër këto objektiva, objektivi i gjashtë dhe i shtatë, përkatësisht, “Identifikim proaktiv dhe menaxhim efektiv i çdo rasti në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje” si edhe “Informim i komunitetit mbi egzistencën e sistemit komunitar të shërbimeve dhe ndërgjegjësim komunitar për të drejtat e çdo individi për të marrë shërbim”, janë realizuar plotësisht. Objektivi specifik 1 dhe 2 janë realizuar thuajse plotësisht, sepse disa nga aktivitetet, si “Zgjerimi i mekanizmit ekzistues për fuqizimin dhe riintegrimin ekonomik e social”; “Masa të Bashkisë për fuqizimin ekonomik”; dhe “Rritja e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në mjedisin publik dhe në shërbime” janë ende në proces zbatimi. Objektivat e tjera janë realizuar pjesërisht.

Objektivi i tretë strategjik, “Sistemi i zgjeruar dhe i organizuar i shërbimeve të kujdesit shoqëror do të mundësojë zhvillim, rehabilitim, riintegrim, pavarësinë dhe përfshirjen shoqërore të individëve dhe familjeve që i kanë të nevojshme këto shërbime”, përbëhet nga një objektiv specifik. Ky objektiv është realizuar në masën 60% sepse 6 nga 10 aktivitete janë realizuar. Ngritja e shërbimeve të reja dhe kalimi i Qendrës “Lira” në Qendër multifunkionale për personat me aftësi të kufizuara, Ngritja e Qendrës Multi-funkionale Rajoni 3 si edhe “Shërbimi i këshillimit me telefon”, nuk janë realizuar.

Objektivi i katërt strategjik, “Sistemi komunitar i shërbimeve të kujdesit shoqëror përmbush standartet kombëtare të cilësisë dhe përshtatshmërisë dhe mban në konsideratë këndvështrimin e komunitetit”, i përbërë nga dy objektiva specifike, është realizuar pjesërisht sepse të gjitha aktivitetet janë ende në proces realizimi.

Vlerësimi i shkallës të realizimit të secilit objektiv specifik dhe objektivave strategjike është ilustruar edhe nëpërmjet krahasimit të vlerave faktike të treguesve të monitorimit, me vlerat e planifikuara. Raporti i detajuar i vlerësimit të planit social 2023-2027 paraqitet në Shtojcën 3.

Faktorët themelorë pengues për realizimin e objektivave të formuluar konsiderohen:

- Pamjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore dhe financiare.
- Mbështetja financiare nga Fondi Social dhe sektori privat, nuk u realizua
- Kapacitetet njerëzore të ofruesve të shërbimeve, rezultuan të pamjaftueshme.
- Partnerët e bashkisë nuk kanë qenë bashkëpunues për të gjitha objektivat e planit social.
- Në dis araste, ka munguar edhe mbështetja e drejtuesve të bashkisë.

Analiza e shkallës së realizimit të planit të mëparshëm tregoi gjithashtu se institucionet dhe organizatat lokale kanë qenë të përfshira edhe në hartimin, edhe në zbatimin e planit të mëparshëm. Konkretisht, jo vetëm bashkia, niveli politik drejtues, niveli ekzekutiv drejtues dhe teknik, por edhe Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë, Zyra e Punës, Zyra Rajonale e Shërbimit Social, OJF dhe Shoqata në mbrojtje të të drejtave të grupeve të përjashtuara, janë përfshirë në mënyrë aktive dhe të ndërgjegjshme, në zbatimin e planit social. .

Për shkak të shkallës së lartë të përfshirjes të strukturave më thelbësore, Planit Social 2024-2027 ka patur ndikim në ndërgjegjësimin e pushtetit vendor në domosdoshmërinë e rritjes së vëmëndjes ndaj të drejtave sociale të grupeve të përjashtuara, të cilët gjithashtu janë më të ndërgjegjësuar në raport me të drejtat e tyre. Ata njohin funksionimin e strukturave të mbrojtjes sociale dhe kërkojnë shërbimet që kanë nevojë, paralelisht me njohjen dhe vlerësimin e mbështetjes së siguruar nga pushteti vendor.

Pavarësisht arritjeve, ekipi i bashkisë është përballuar me sfida kritike përgjatë rrugëtimit 3 vjeçar të zbatimit të Planit të Përkujdesit Social. Konkretisht, çështjet më kritike konsiderohen:

- Legjislacioni i cunguar, që nuk krijon hapësira për vetëveprim e inisiativa lokale;
- Papunësia;
- Varfëria;
- Buxhetet e kufizuara.

Përveç vlerësimit të shkallës së realizimit të objektivave, metodologjia e ndërtuar posaçërisht për këtë vlerësim, përbëhej edhe nga dy komponentë të tjerë, përkatësisht:

- Analiza dhe vlerësimi i nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror duke përdorur pyetSORIN individual 2 si edhe formularin shoqërues 3 si instrumenta të kërkimit.
- Vlerësimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare për sigurimin e shërbimeve sipas nevojës, nëpërmjet mbledhjes të të dhënave duke përdorur formularin 4 si instrument kërkimi.

PyetSORI 2, formularët 3 dhe 4 gjithashtu paraqiten tek Shtojca 1.

Të gjitha përfundimet e sipërpërmendura janë përfshirë në hartimin e kuadrit llogjik të planit të ri social si edhe në përcaktimin e mënyrave, nëpërmjet të cilave do të trajtohen problemet më kritike në funksion të ndërtimit të shërbimeve efektive sociale për të garantuar të drejtat sociale të qytetarëve të bashkisë Berat.

3. Kuadri logjik i Planit të Përkujdesit Social, 2027-2030

3.1. Baza legjislative

Politikat vendore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror mbështeten në kuadrin ligjor dhe strategjik kombëtar të mbrojtjes sociale, i cili synon garantimin e aksesit të barabartë në shërbime cilësore për të gjithë qytetarët, pa diskriminim për shkak të gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar, statusit social, etnisë, bindjeve fetare apo politike dhe karakteristikave të tjera individuale.

Dokumenti kryesor strategjik që orienton zhvillimin e sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri është Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024–2030, e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 13.03.2024. Strategjia synon garantimin e një jetese me dinjitet për çdo individ gjatë gjithë ciklit të jetës, reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit social, fuqizimin e familjeve dhe individëve drejt vetëpërfshirjes ekonomike, si

dhe zgjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror në të gjithë territorin e vendit.

Në veçanti, Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024–2030 synon konsolidimin e sistemit të decentralizuar të shërbimeve sociale, zgjerimin e mbulimit gjeografik të shërbimeve komunitare, forcimin e mekanizmave të identifikimit dhe referimit të rasteve në nevojë, përmirësimin e financimit të qëndrueshëm të shërbimeve sociale dhe rritjen e koordinimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030, në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, bashkitë mbeten aktorët kryesorë për planifikimin, organizimin, financimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor. Për këtë arsye, ato kanë përgjegjësinë për të vlerësuar nevojat sociale të komunitetit, për të hartuar dhe zbatuar plane sociale vendore dhe për të siguruar aksesin e grupeve vulnerabël në shërbime të përshtatshme dhe cilësore.

Në përputhje me nenin 24 të Ligjit nr. 139/2015, bashkitë ushtrojnë funksione në fushën e mbrojtjes sociale, duke përfshirë krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë, ngritjen dhe administrimin e qendrave të shërbimeve sociale, si dhe krijimin dhe administrimin e Fondit Social në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.

Hartimi i Planit Social Vendor është një detyrim ligjor që rrjedh nga neni 36 i Ligjit nr. 121/2016. Plani Social përbën instrumentin kryesor të planifikimit vendor për zhvillimin e shërbimeve sociale, duke u mbështetur në vlerësimin e nevojave të komunitetit, në paketën bazë të shërbimeve sociale dhe në prioritetet strategjike kombëtare e vendore.

Financimi i shërbimeve sociale realizohet përmes Fondit Social, i cili mbështetet nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore, kontributet e donatorëve dhe burime të tjera të ligjshme financimi. Mekanizmat e financimit dhe metodologjia e përlllogaritjes së fondeve rregullohen nga legjislacioni përkatës në fuqi, përfshirë VKM nr. 111/2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social” dhe VKM nr. 150/2022 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”.

Për garantimin e ofrimit efektiv të shërbimeve, bashkitë organizojnë strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale dhe Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, të cilat sigurojnë identifikimin, vlerësimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve në nevojë, si dhe koordinimin e mbështetjes ndërmjet institucioneve dhe ofruesve të shërbimeve sociale.

Plani Social 2027-2030 hartohet në përputhje me prioritetet kombëtare të vendit dhe ato të bashkisë Berat, në përputhje me nenet 70 dhe 99, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, dokumentin e Partneritetit 2007 si pjesë thelbësore e kuadrit afatgjatë strategjik të Shqipërisë të përcaktuar nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHE 2030), me qëllim përshpejtimin e procesit të integritimit evropian dhe përafrimin e politikave sociale me standardet e Bashkimit Evropian.

3.1 Vizioni

Mbrojtje sociale në një mjedis mundësues dhe fuqizues për çdo individ në nevojë në bashkinë Berat, duke garantuar jetesë dinjitoze përgjatë ciklit të jetës.

3.2 Misioni

Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Berat do të garantojë shërbime të kujdesit shoqëror me cilësi të lartë në bashkëpunim me OJF-të dhe sektorin privat për të përmirësuar jetën e fëmijëve dhe të të rriturve, të përjashtuar dhe/ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

3.3 Vlerat dhe parimet udhërrëfyese

3.3.1 Vlerat

Plani Social i Bashkisë Berat përgjatë realizimit të misionit do të ndihmojë në:

- ✓ Rritjen e përgjegjësi të pushtetit lokal për të mundësuar, mbështetur, mbrojtur dhe garantuar realizimin e të drejtave sociale të qytetarëve të bashkisë Berat, në radhë të parë, të atyre më të përjashtuar dhe në rrezik përjashtimi;
- ✓ Forcimin e kapaciteteve institucionale që ofrojnë shërbime të integruara dhe të veçanta për individë dhe grupe në nevojë kritike, si në komunitet ashtu dhe në familje;
- ✓ Sigurimin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit midis qeverisë qendrore, pushtetit vendor dhe rrjetit të organizatave jofitimprurëse;
- ✓ Fuqizimin e institucioneve të pushtetit vendor, sidomos në drejtim të identifikimit të personave "në nevojë" ose "të rrezikuar" si dhe të vendimmarrjes mbështetur në parimin e interesit më të mirë të qytetarit dhe të respektimit të të drejtave sociale;
- ✓ Zbatimin e praktikave të mira dhe të modeleve të përparuara të financimit të shërbimeve sociale;
- ✓ Përdorimin me efektivitet të Fondit Social dhe përcaktimin e proceseve që garantojnë përdorimin e tij;
- ✓ Zgjerimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve, në drejtim të përfshirjes dhe fuqizimit të bashkëpunimit me partnerë tradicionalë dhe jo tradicionalë, duke synuar interesin më të mirë të qytetarit;
- ✓ Vëzhgimin/mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të miratuara të shërbimeve sociale, pavarësisht nga format dhe tipologjitë e shërbimeve.

3.3.2. Parimet udhëheqëse

Hartimi i Planit Social të Bashkisë Berat udhëhiqet nga parimet që vijnë:

- ✓ Respektimi dhe garantimi i të drejtave për mbrojtje dhe siguri sociale në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar;
- ✓ Nxitja e pjesëmarrjes të grupeve përfituese dhe grupeve të tjera të interesit, përgjatë procesit të hartimit të planit si edhe të monitorimit të zbatimit të tij ;
- ✓ Fuqizimi në nivel personal dhe komunitar i individëve në nevojë, duke realizuar integrimin dhe përfshirjen e tyre në aktivitete ekonomike e sociale;
- ✓ Zbatimi i politikave lokale të mbështetura në parimet e mbrojtjes të interesit më të mirë të fëmijës dhe të respektimit të barazisë gjinore ;
- ✓ Ndërtimi i politikave lokale në përputhje me kompetencat vendore që rrjedhin nga Ligji mbi Reformën Territoriale.

- ✓ Garantimi i aksesit të barabartë tek shërbimet e decentralizuara të shërbimeve shoqërore;
- ✓ Ofrimi i shërbimeve shoqërore të ndërtuara mbi parimin e de-institucionalizimit;
- ✓ Ndërtimi i shërbimeve të qëndrueshme nga pikëpamja financiare dhe kosto-efektive.
- ✓ Krijimin e Fondit Social për financimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale.

3.3.3 Procesi i hartimit të Planit Social 2027-2030

Procesi i hartimit të Planit Social Vendor u konceptua si një proces gjithëpërfshirës dhe kompleks, i cili ndërthur disa komponentë metodologjikë dhe analitikë, me qëllim sigurimin e një analize të plotë të situatës sociale dhe planifikimin e ndërhyrjeve për periudhën 2027–2030. Ky proces u mbështet në disa elementë kryesorë:

1. Analiza e zbatimit të Planit ekzistues (2023–2026).

U realizua një analizë e thelluar e arritjeve dhe sfidave të Planit ekzistues përmes vlerësimit të aktiviteteve të realizuara, objektivave specifike dhe qëllimit strategjik, si dhe analizës së buxheteve të shpenzuara sipas objektivave dhe treguesve të monitorimit (instrumentet e vlerësimit paraqiten në Shtojcën 1).

Instrumenti thelbësor, Pyetësi 1, përbëhet nga një listë e strukturuar pyetjesh, e administruar përmes intervistave ballë për ballë me zyrtarët kryesorë të bashkisë dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror që veprojnë në territorin e saj. Qëllimi i këtyre intervistave është mbledhja e evidencave mbi nivelin e zbatimit dhe arritjes së objektivave të Planit Vendor të Kujdesit Shoqëror, identifikimi i sfidave dhe pengesave kryesore, si dhe vlerësimi i progresit në raport me treguesit e monitorimit. Për të plotësuar analizën, u përdorën gjithashtu Formulari 1 dhe 2. Formulari 1 dokumenton aktivitetet e realizuara në raport me ato të planifikuara për çdo objektiv specifik, duke pasqyruar nivelin e zbatimit dhe progresin e arritur, ndërsa Formulari 2 regjistron shpenzimet faktike në raport me fondet e planifikuara, duke mundësuar analizën e performancës financiare dhe përputhshmërisë së burimeve të planifikuara dhe atyre të përdorura.

2. Analiza shumëdimensionale e nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror.

Instrumentet e analizës paraqiten në Shtojcën 1. Instrumenti kryesor, Pyetësi 2, përbëhet nga një listë e strukturuar pyetjesh, e administruar përmes intervistave me të gjithë ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror që veprojnë në territorin e bashkisë. Qëllimi i këtyre intervistave është mbledhja e evidencave për vlerësimin e nevojave prioritare të grupeve në nevojë, vulnerabël dhe të përjashtuara socialisht. Bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura përmes Pyetësit 2, u identifikuan prioritetet kryesore për periudhën 2027–2030. Formulari 3, i përdorur në mbështetje të Pyetësit 2, përmbledh të dhëna statistikore mbi grupet e përjashtuara, të ndara sipas moshës, gjinisë dhe statusit socio-ekonomik.

3. Vlerësimi i kapaciteteve njerëzore, institucionale dhe financiare.

Instrumentet e analizës paraqiten në Shtojcën 1. Ky komponent fokusohet në vlerësimin e kapaciteteve njerëzore, financiare dhe institucionale të nevojshme për zbatimin efektiv të Planit Social Vendor. Evidencat u mbledhën nga burime dytësore përmes Formularit 4 dhe Formularit 5. Formulari 4 pasqyron shpenzimet për mbrojtjen sociale dhe shërbimet e kujdesit shoqëror gjatë pesë viteve të fundit, si dhe shpenzimet e planifikuara në kuadër të Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA). Formulari 5 ofron një pasqyrë të kapaciteteve ekzistuese njerëzore dhe institucionale të angazhuara në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki. -

4. Analiza gjithëpërfshirëse dhe përcaktimi i prioritetëve.

Realizimi i analizës të integruar të të dhënave nga burimet parësore dhe dytësore, mundësoi formulimin e prioritetëve për periudhën 2027–2030, përmes kombinimit të analizës sasiore dhe cilësore të nevojave dhe drejtimeve të ndërhyrjes.

5. Forcimi i kapaciteteve institucionale.

U realizuan tre takime/seminare me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve, me qëllim rritjen e kapaciteteve të bashkisë për hartimin e planeve strategjike afatmesme (evidencat paraqiten në Shtojcën 2).

Plani Social i Bashkisë Berat, i hartuar nëpërmjet procesit gjithëpërfshirës dhe kompleks, trajton nevojat dhe sfidat sociale të qytetarëve, përfshirë varfërinë, papunësinë, mungesën e aksesit në shërbimet shëndetësore dhe arsimore, si dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rriturve. Plani ofron një vizion të qartë dhe të strukturuar për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve përmes politikave dhe masave gjithëpërfshirëse sociale. Zbatimi i suksesshëm i Planit Social Vendor kontribuon në përmirësimin e infrastrukturës sociale, rritjen e aksesit në shërbimet thelbësore dhe krijimin e mundësive për një jetë më të mirë dhe më të qëndrueshme për të gjithë qytetarët.

Bashkia Berat e ndërmori hartimin e këtij Plani jo vetëm për të përmbushur detyrimet ligjore, por edhe për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe për të garantuar mbështetje për qytetarët në nevojë. Plani nuk përfaqëson thjesht një dokument administrativ, por një instrument strategjik për koordinimin e shërbimeve sociale dhe për sigurimin që asnjë individ të mos mbetet pas. Nëpërmjet këtij Plani, bashkia ndërton një qasje strategjike për reduktimin e varfërisë, përjashtimit social dhe diskriminimit, duke promovuar barazinë dhe adresuar nevojat specifike të grupeve të ndryshme.

Transparenca në procesin vendimmarrës rrit besueshmërinë dhe hapjen ndaj qytetarëve, duke forcuar përgjegjshmërinë sociale dhe ligjore. Hartimi i Planit Social Vendor është në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjik në fuqi në Republikën e Shqipërisë, përfshirë Kushtetutën, konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, Kartën Sociale Evropiane (të rishikuar), Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, standardet e OBSH-së, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030, Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe Ligjin nr. 121/2016 “Për Shërbimin e Kujdesit Shoqëror në

Republikën e Shqipërisë”. Këto akte përcaktojnë detyrimet e bashkive për identifikimin e nevojave, planifikimin e burimeve dhe ofrimin e shërbimeve të koordinuara sociale.

Procesi për hartimin e Planit Social kaloi në gjashtë faza kryesore:

Faza 1 – Vendimmarrja politike dhe teknike. Gjatë muajve mars–prill 2026, Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, morën vendimin për hartimin e Planit Social Vendor 2027–2030.

Faza 2 – Mbledhja e të dhënave . Gjatë periudhës 22 maj – 15 qershor u mbledhën të gjitha të dhënat e nevojshme për analizën e situatës sociale.

Faza 3 – Analiza dhe prioritarizimi. Të dhënat u analizuan për të identifikuar tendencat, nevojat dhe sfidat kryesore që duhet të trajtohen në plan.

Faza 4 – Hartimi i draft-Planit. U hartua drafti i Planit Social Vendor, duke përcaktuar objektivat, strategjitë dhe veprimet konkrete. Drafti u finalizua më 25 qershor dhe u shpërnda për komente dhe rekomandime tek të gjithë aktorët përkatës.

Faza 5 – Konsultimi publik dhe miratimi. Drafti i rishikuar u hodh për konsultim publik më 9 korrik dhe, pas reflektimit të komenteve, u dorëzua për miratim më 30 korrik 2026.

Faza 6 – Zbatimi. Zbatimi i Planit varet në mënyrë kritike nga sigurimi i burimeve financiare, përtej fondeve të bashkisë.

Kapitulli 9 i Planit paraqet analizën e detajuar të kostove dhe burimeve financiare të mundshme. Mobilizimi i burimeve shtesë përmes Fondit Social, programeve kombëtare, donatorëve dhe instrumenteve të tjera financiare mbetet një kusht thelbësor për realizimin e objektivave të Planit.

Në përfundim të analizave dhe diskutimeve u identifikuan prioritetet thelbësore për periudhën 2027-2030, në mbështetje të të cilave u formuluan qëllimi dhe objektivat strategjike, të cilat paraqiten tek Kapitulli 6.1.

3.3.4 Analiza SWOT

Fuqi:

- ✓ Bashkia Berat, është e motivuar dhe e paisur me kapacitete njerëzore, teknike dhe profesionale, të përshtatshme për të ndërtuar dhe administruar shërbime cilësore sociale.
- ✓ Rritja e eksperiencës së stafit, eksperiencë e fituar kryesisht gjatë zbatimit të planeve të mëparshme sociale.
- ✓ Qytetarët janë të ndërgjegjësuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre, si edhe për detyrimin e bashkisë për të siguruar shërbime cilësore të përkujdesit social.
- ✓ Në bashkinë Berat funksionojnë disa organizata jo fitim prurëse të cilat sigurojnë shërbime efektive dhe cilësore sociale për qytetarët.

Dobësi:

- ✓ Varfëria, zhvillimi i kufizuar i biznesit dhe tregut të punës.
- ✓ Tkurra e popullsisë, kryesisht e popullsisë në moshë pune.
- ✓ Mundësi të kufizuara financiare

Mundësi:

- ✓ Krijimi dhe forcimi i Fondit Social dhe atij lokal
- ✓ Rritja e mundësive për aplikim për financime nga donatorët për shërbimet sociale.
- ✓ Vlerësimi me përparësi i zhvillimit të sistemit të shërbimeve sociale, nga qeveria.

Kufizime

- ✓ Mundësi të kufizuara të pjesëmarrjes të sektorit privat në mbështetjen e shërbimeve sociale në Berat.

4. Analiza e situatës

4.1. Të dhëna demografike

Të dhënat demografike janë të rëndësishme jo vetëm për të vlerësuar madhësinë e grupeve në nevojë për shërbime në raport me popullsinë e Bashkisë Berat, por edhe për të vlerësuar burimet njerëzore që duhet të ketë Bashkia në dy nivelet e organizimit (Bashki dhe njësi administrative) si detyrim që rrjedh nga legjislacioni kombëtar.

Sipas regjistrit të gjendjes civile, popullsia e bashkisë Berat, në territorin e riorganizuar në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, është 91.480 banorë(Tabela 1).

Tabela nr.1: Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimit mbështetur në të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile


Njësia Administrative	Numri i Popullsisë	Vendbanimi (persona)		Gjinia	
		Urban	Rural	Femra	Meshkuj
Berat	59.428	59.428		30.005	29.423
Velabisht	11.100		11.100	5.577	5.523
Otlak	13.032		13.032	6.169	6.863
Sinjë	4.478		4.478	1.916	2.562
Rroshnik	2.839		2.839	1.276	1.563
Gjithsej	90.877	59.428	31.449	44.943	45.934

Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026.

Duke ju referuar treguesve të tjerë demografikë, konstatohet se:


- ✓ Bashkia Berat është urbane, meqenëse rreth 65% e popullsisë jeton në zonën urbane.
- ✓ Shpërndarja sipas gjinisë është thajse e barabartë, me një përparësi të lehtë të gjinisë mashkullore (51%).

Figura 1 dëshmon se 65% e popullsisë jeton në qytetin e Beratit, ndërsa 35% në njësité e tjera administrative që përbëjnë bashkinë (Figura 1).



Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026.

Grup mosha 25 deri 65 vjeç përbën grupin më të konsiderueshëm (54%), por në krahasim me 5 vite më parë, përqindja e kësaj grup moshe ka rënie për shkak të lëvizjeve të fuqishme migratore. Grup mosha 0 deri 24 vjeç përbën 29% të popullsisë, tregues tepër domethënës për zhvillimin e forcave prodhuese dhe të punësimit. (Tabela 2 dhe Figura 2).



Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026.

Tabela 2: Popullsia sipas grupmohave

Njësia Administrative	Popullsia	Popullsia sipas grupmohave					
		0-24 vjeç		25-65 vjeç		Mbi 65 vjeç	
		Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Berat	59.428	11.841	5.202	30.167	15.229	10.247	5.622
Velabisht	11.100	3.482	1.364	8.135	4.161	2.028	1.086
Otlak	13.032	3.882	1.849	9.457	4.450	2.676	1.292
Sinjë	4.478	1.483	601	3.151	1.253	834	426
Rroshnik	2.839	713	328	2.225	923	554	308
Gjithsej	90.877	21.402	9.344	53.136	26.016	16.339	8.733

Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026.

4.2. Grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi

4.2.1. Përfituesit e Ndhmës ekonomike

Informacionet dhe diskutimet me punonjësit e bashkisë, përgjegjës për shërbimet e përkujdesit shoqëror konfirmojnë se varfëria, mungesa e të ardhurave ose pamjaftueshmëria e tyre, janë shkak themelor i përjashtimit shoqëror të familjes dhe individëve të saj. Në bashkinë e Berat përfitojnë ndihmë ekonomike 622 familje ose 1.546 individë, 91% e aplikantëve që përbën 2% të popullsisë.

Tabela 3 ilustron përqindjen e përfituesve të ndihmës ekonomike në raport me popullsinë e bashkisë dhe të secilës njësi administrative. Siç vërehet, përfituesit e ndihmës ekonomike

përbëjnë 2% të popullsisë së bashkisë, përkatësisht 8% të popullsisë në njësinë Sinjë (përqindja më e lartë), ndërsa 1% në Berat dhe Velabisht (përqindja më e ulët). Siç mund të konfirmohet lehtësisht, përqindja e përfituesve të ndihmës ekonomike në krahasim me popullsinë është relativisht e ulët, ndërsa 91% e aplikantëve mbështeten ekonomikisht.

Tabela 3: Individë përfitues të ndihmës ekonomike, numër dhe përqindje.

Njësitë Administrative	Popullsia		Aplikantë NE Familje	Përfitues NE Familje	% Përfitues; Aplikues	Individë përfitues NE		% Përfitues NE/ Popullsi	
	Gj	F	Gjithsej	Gjithsej		Gj	F	Gj	F
Berat	59.428	30.005	454	405	89%	717	394	1	1
Velabisht	11.100	5.577	33	31	94%	126	71	1	1
Otlak	13.032	6.169	74	70	95%	239	128	2	2
Sinjë	4.478	1.916	87	83	95%	337	156	8	8
Rroshnik	2.839	1.276	35	33	94%	127	65	4	5
Gjithsej	90.877	44.943	683	622	91%	1.546	814	2	2

Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026.

Tabela 4 ilustron përbërjen e përfituesve të ndihmës ekonomike. Vërehet se “fëmijë deri 16 vjeç” përbëjnë 12% të përfituesve të ndihmës ekonomike, Gratë kryefamiljare 7%, Individët me AK, 6%, dhe Fëmijë me AK 1%.

Tabela 4: Përfituesit e ndihmës ekonomike, sipas përbërjes.

Njësia Administrative	Individë Përfitues		Fëmijë deri 16 vjeç		Të moshuar		Gra Kryefa miliare	Individë AK		Fëmijë AK	
	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	Gj	F	Gj	F
Berat	717	394	184	109	32	13	86	28	12	11	3
Velabisht	126	71			13	3	8	14	8	2	2
Otlak	239	128			8	3	4	22	11		
Sinjë	337	156	3		4	2	11	18	10	5	2
Rroshnik	127	65			0	0	2	4	2		
Gjithsej	1.546	814	187	109	57	21	111	86	43	18	7
Në përqindje			12	13	4	2.5	7	6	5	1	0.8

Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026.

Analiza tregon se varfëria, duke gjykuar nga përqindja e familjeve përfituese të NE, është fenomen kryesisht “rural”. Fëmijët zënë një peshë të konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të anëtarëve të familjeve përfituese të NE, gjë e cila duhet të konsiderohet në

hartimin e politikave lokale të mbështetjes nëpërmjet NE ose formave të tjera të shërbimeve sociale. Gratë kryefamiljare gjithashtu përbëjnë një përqindje të konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të familjeve përfituese të NE.

4.2.2. Aftësia e kufizuar

3% e popullsisë në Bashkinë Berat (referuar të dhënave të bashkisë, Tabela 5) është me aftësi të kufizuar ose invaliditet pune. Nga 2.983 persona me AK dhe invaliditet, 6% janë fëmijë dhe 15 % janë të moshuar.

24% e personave me aftësi të kufizuar, 17% e të cilëve janë fëmijëve me AK, kanë një formë shumë të rëndë të aftësisë së kufizuar e për rrjedhojë kanë të drejtën e një kujdestari/ndihmësi me pagesë që kujdeset për ta.

Tabela 5: Individët me AK, sipas përbërjes dhe përfitimeve monetare.


Njësia Administrativ e	Individë AK				Fëmijë AK				Të moshuar AK	Invalidë pune	Gjithsej			
	Përfitojnë PAK,		Përfitojnë pagesë Kujdestari e		Përfitojn ë PAK		Përfitojnë pagesë kujdestari e							
	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F					Gj	F
Berat	1.005	510	252	151	117	51	44	20	315	133	1.107	479	2.112	989
Velabisht	216	107	59	50	26	9	11	8	52	31	66	20	282	127
Otllak	226	106	40	27	23	10	6	3	51	22	92	38	318	144
Sinjë	117	52	22	15	4	1	4	1	38	18	33	18	150	70
Rroshnik	89	39	24	20	4	0	2	0	21	10	32	14	121	53
Gjithsej	1.653	814	397	263	174	71	67	32	477	214	1.330	569	2.983	1.383

Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026.

71% e personave me aftësi të kufizuara banojnë në njësinë administrative Berat, ndërsa 29% e tyre banojnë në njësitë e tjera administrative. (figura 3).

Aftësia e kufizuar është një nga faktorët më kritikë të përjashtimit shoqëror. Në Bashkinë Berat, personat me aftësi të kufizuar përjetojnë përjashtim të shumfishtë sepse përveç aftësisë së kufizuar, janë të përjashtuar nga tregu i punës si edhe nga mundësia për të siguruar një nivel të pranueshëm jetese.

Figura 3: % e individëve me AK sipas njësive administrative



Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026

4.2.3. Punëkërkuesit e papunë

Janë gjithsej 1.705 punëkërkues të papunë në Bashkinë Berat. Papunësia në Berat ka profil krejtësisht urban dhe femëror. Vihet re se gratë e papuna mbi 25 vjeç përbëjnë 45% të të papunëve të regjistruar, ndërsa gratë kryefamiljare përbëjnë 11%. Të rinjtë deri 25 vjeç përbëjnë 16%, ndërsa komuniteti rom dhe egjiptian përbën 13% të të gjithë të papunëve të regjistruar. 6% e të papunëve përfitojnë pagesë papunësie. (tabela 6).

Tabela 6: Të dhëna mbi punëkërkuesit e papunë, numër dhe përqindje

Sipas statusit	Nr. i individëve	Sipas gjinisë		% ndaj punëkërkuesve të papunë
		Femra	Meshkuj	
Përfitojnë pagesë papunësie	124	65	59	7
Përfitojnë nga PFP	103	49	54	6
Romë/ Egjiptianë	65/152	39/75	26/77	13
Emigratë të kthyer	26	11	15	1.5
Gra mbi 25 vjeç, jo kryefamiljare	772	772		45
Gra kryefamiljare	186	186		11
Të rinj deri 25 vjeç	277	144	133	16
Gjithsej	1.705	1.341	364	100
Në %	100	83	17	

Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026

4.2.4. Fëmijët e përjashtuar ose në rrezik përjashtimi

2% e fëmijëve janë të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi për shkak të varfërisë së familjeve, aftësisë së kufizuar, keqtrajtimit, abuzimit ose braktisjes. Ndër fëmijët në nevojë kritike për mbrojtje, vajzat përbëjnë pjesën më të madhe.

Shkaku kryesor i përjashtimit të fëmijëve është varfëria e familjes. 44% e fëmijëve në nevojë e përbëjnë fëmijët e familjeve në NE, 41% fëmijët me AK, 15% fëmijë të tjerë në nevojë për mbrojtje. (tabela 7).

Tabela 7: Fëmijë në situatë kritike dhe në nevojë për mbrojtje.

Njësia administrative	Fëmijë gjithsej		Fëmijë në familje me NE		Fëmijë me AK gjithsej		Fëmijë të dhunuar		Fëmijë të tjerë në nevojë për mbrojtje		Fëmijë të braktisur		Fëmijë gjithsej në nevojë	
	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F
Berat	11.841	5.202	184	109	117	51	26	18	13	10	8	4	348	192
Velabisht	3.482	1.364			26	9	2	2			1	1	29	12
Otllak	3.882	1.849			23	10	2	1	2	1	4	2	31	14
Sinjë	1.483	601	3		4	1	4	2					11	3
Rroshnik	713	328			4	0	0						4	0
Gjithsej	21.402	9.344	187	109	174	71	34	23	15	11	13	7	423	221
Në %			44	49	41	32	8	10	4	5	3	3		
Në %													2	2

Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026

4.2.5. Gra në situatë kritike

Me qëllim evidentimin e kategorive të grave më të përjashtuara si edhe arsyet e përjashtimit, është ndërtuar Tabela 8, e cila paraqit informacion sasior të përmbledhur, mbi numrin e grave kryefamiljare në familjet përfituese të NE, numrin e grave me aftësi të kufizuar, numrin e grave viktime të dhunës në familje si edhe numrin e punëkërkueseve gra.

Numri i punëkërkueseve gra për efekt të ndërtimit të tabelës 8 dhe të eliminimit të rrezikut të paraqitjes së informacionit artificialisht të rritur, është llogaritur si diferencë e numrit të punëkërkueseve të paraqitur në tabelën 6 me numrin e grave kryefamiljare, përfituese të NE të tabelës 4, sepse gratë kryefamiljare, përfituese të NE janë të papuna.

Tabela 8 dëshmon se 5% e grave në bashkinë Berat përjetojnë situatë kritike përjashtimi për shkak të pamjaftueshmërisë të të ardhurave ose arsyeve të tjera.

Tabela 8: Numri i grave në situatë kritike

Njësia administrative	Gra gjithsej	Kryefamiliares Përfutuese NE	Të shfrytëzuara /të dhunuara	Të papuna	Me AK	Invalide pune	Gra gjithsej në nevojë	Në %
Berat	30.005	86	15	649	510	479	1.739	6
Velabisht	5.577	8	2	4	107	20	141	3
Otlak	6.169	4	1		106	38	149	2
Sinjë	1.916	11	0	8	52	18	89	5
Roshnik	1.276	2	0		39	14	55	4
Gjithsej	44.943	111	15	661	814	569	2.170	5

Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026.

4.2.6.Të moshuar në situatë kritike

Analiza e situatës të të moshuarve konsideron tregues kompleksë shëndetsorë, sociale dhe ekonomikë.

Tabela 9 paraqit përqindjen e të moshuarve në nevojë për shërbime sipas treguesve kompleksë të shpjeguar më lart. Siç vërehet, rreth 5% e të moshuarve, jetojnë në kushte kritike.

Përqindja më e lartë e të moshuarve në nevojë për mbrojtje është në njësinë Sinjë, e pasuar nga njësia Rroshnik.

Tabela 9: Të moshuarit në situatë kritike.

Njësitë administrative	Të moshuar mbi 65 vjeç		Në familje NE		AK dhe me problem e kritike shëndeti		Pa pension		Të braktisur, pa strehë, situatë kritike		Të moshuar në nevojë gjithsej		Në %	
	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F
Berat	10.247	5.622	32	13	337	151	76	24	18	5	463	193	5	3
Velabisht	2.028	1.086	13	3	60	32	12	5	2	0	87	40	4	4
Otlak	2.676	1.292	8	3	59	28	15	6	1	0	83	37	3	3
Sinjë	834	426	4	2	173	79	8	3	2	0	187	84	22	20
Rroshnik	554	308	0	0	52	27	2	1	0	0	54	28	10	9
Gjithsej	16.339	8.733	57	21	681	317	113	39	23	5	874	382	5	4

Burimi: Zyra për Shërbimet Shoqërore në bashki dhe drejtoria rajonale e kujdesit shëndetsor, Berat, Maj 2026.

4.2.7.Minoritetet etnike

Komunitetet etnike Romë dhe Egjyptianë përbëjnë rreth 20% të popullsisë, kryesisht të përqendruar në qytetin e Beratit dhe njësinë Otlak, nga të cilët 217 janë punëkërkes të papunë.

4.3. Profili i shërbimeve që ofrohen në bashkinë Berat

4.3.1. Shërbimet dhe institucionet e përkujdesit shoqëror


Në bashkinë Berat funksionojnë 10 ofrues të shërbime që sigurojnë 44 shërbime të përkujdesit shoqëror, për 842 përfitues. (tabela 10).

Tabela 10. Shërbimet e përkujdesit shoqëror; Bashkia Berat

Ofruesit e shërbimeve sipas tipologjisë	Ofrues	Shërbime	Përfitues
Rezidenciale			
Ditore	1	3	30
Komunitare	2	6	61
Qendra zhvillimi	2	9	108
Shumë disiplinore	1	8	70
Strehëz emergjence	1	4	8
Shërbim lëvizës	2	11	92
Fondacione/shoqata	1	3	473
Gjithsej	10	44	842
Publikë	9	41	369
Jo Publikë	1	3	473

Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026

90% e ofruesve janë publikë, të cilët ofrojnë shërbime për rreth 50% të përfituesve. Në krahasim me tre vite më parë, numri i ofruesve të shërbimeve është rritur me 40% (figura 4), numri i përfituesve është rritur me 20% si edhe numri i shërbimeve. Ofruesit sigurojnë shërbime të të gjitha tipologjive për të gjitha grupet e përfituesve.



Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026

4.3.2. Përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror

Përfituesit e shërbimeve në bashkinë Berat janë kryesisht Individët e familjeve në nevojë, komuniteti rom dhe egjiptian, të rinj në nevojë, të moshuarit, të rriturit me AK, fëmijët me AK, viktimat e dhunës dhe fëmijët jashtë kujdesit prindëror.

Tabela 11: Përfitues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror								
Grupet e përfituesve	Gjithsej	Femra	0-25vjeç		25-65 vjeç		Mbi 65 vjeç	
			Gj	F	Gj	F	Gj	F
Individë të familjeve në nevojë	245	156	142	69	82	80	21	7
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	7	4	7	4				
Fëmijë AK	59	35	59	35				
Të rritur AK	60	20			60	20		
Të rinj në nevojë	141	42			141	42		
Viktima të dhunës	41	41			40	40	1	1
Romë/Egjiptianë	219	140	116	65	40	37	63	38
Të moshuar	70	13					70	13
Gjithsej	842	451	324	173	363	219	155	59

Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026

Analiza e thelluar e shërbimeve të përkujdesit shoqëror e krahasuar me nevojën për shërbime si edhe situatën e përgjithshme të grupeve në kushte më kritike tregon se shkalla e plotësimit të nevojës për shërbime është 20%, relativisht i lartë, në krahasim me shumë bashki të tjera të vendit.

Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese është negativ, gjë që dëshmon pamjaftueshmërinë e kapaciteteve ofruese. Siç tregon figura 5, tek shërbimet për fëmijët me AK, individët në nevojë ekonomike si edhe të moshuarit, nuk ka hapësirë për përfitues të rinj, ndërsa për individë në kushte të vështira ekonomike ka shumë pak hapësirë për përfitues të rinj.

Figura 5: Tregues jo të drejtëpërdrejtë të nevojës për shërbime.

Berat	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	1154	30	245	34	18%	88%	-717%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	55	10	7	2	11%	78%	30%
Fëmijë me aftësi të kufizuar	209	20	59	1	22%	98%	-195%
Të rritur me aftësi të kufizuar	1876	80	60	5	3%	92%	25%
Të rinj në kushte kritike	6	0	141	6	96%	96%	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	5	50	41	5	89%	89%	18%
Të moshuar	16	100	219	8	93%	96%	-119%
Romë dhe Egjiptianë	0	80	70	0	100%	100%	13%
Gjithsej	3321	370	842	61	20%	93%	-128%


Burimi: Hartëzimi i Shërbimeve Shoqërore, 2025

4.3. 3 Burimet njerëzore, ofruese të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

85 punonjës, përkatësisht 23 në bashki dhe 62 në institucione sigurojnë funksionimin e sistemit të përkujdesit shoqëror në bashkinë Berat, duke ofruar përfitime monetare dhe shërbime ndaj qytetarëve në nevojë. I gjithë stafi është me arsim të lartë dhe pas universitar. Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në të gjitha njësitë administrative nuk është krijuar ende, ndërsa të gjitha strukturat e tjera, krijimi i të cilave është detyrim ligjor, duhet të plotësohen me staf që të funksionojnë me efikasitet. Regjistri elektronik gjithashtu nuk është populluar ende me të dhëna, për rrjedhojë, ende nuk përdoret, përfundimisht çështja e plotësimit të nevojave me staf të kualifikuar është dhe mbetet problem kritik.

Figura 6 ilustron treguesin e përfituesve mesatarisht për 1 punonjës të shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Vërejmë se ndërsa 1 punonjës i institucioneve mesatarisht duhet të kujdeset për 48 individë në nevojë, 1 punonjës i bashkisë dhe institucioneve duhet të kujdeset për 275 persona në nevojë, nëse konsiderojmë të gjithë ata që i drejtohen bashkisë për ndihmë dhe mbështetje, dmth nëse përfshijmë edhe pagesat monetare. Treguesi i dytë është relativisht i lartë, duke konsideruar jo vetëm nivelin e kërkesës në aspektin sasior por edhe detyrimin për të realizuar standartet e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit.

Figura 6: Treguesi Përfitues/Staf, raport



Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026

Për më tej, mbështetur në legjislacionin ekzistues mbi strukturat e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit duhet të ketë 1 punonjës për 6.000 banorë, ndërsa Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve duhet të ketë 1 punonjës për 3.000. Për rrjedhojë, nevoja për staf dhe kualifikim të mëtijshëm është e evidente. Plan i Social evidendon me saktësi nevojat edhe në këtë drejtim, përgjatë përpunimit të komponentit të burimeve njerëzore, institucionale e financiare në funksion të realizimit të objektivave të planit.

4.4. Përmbledhje: Grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi

Për të llogaritur individët në nevojë në bashkinë Berat përdoren të gjitha të dhënat e paraqitura në tabelat nga 1 deri 13. Rezultatet e përmbledhura paraqiten në vijim, tek Tabela 13. Për të ndërtuar tabelën 13, si përmbledhje të të gjitha grupeve të analizuara, u ndërmorën disa veprime me qëllim që të dhënat të pasqyrojnë situatën reale. Kështu:

- ✓ Për të llogaritur Individë në nevojë, nga numri i përgjithshëm i përfituesve të NE, u hoqën fëmijët, të moshuarit, gratë e vetme, individët me AK, që janë përfitues të NE.
- ✓ Për të llogaritur individët AK, nga numri i përgjithshëm, u hoqën fëmijët me AK dhe të moshuarit.
- ✓ Grupet Gra, Fëmijë dhe të Moshuar në situatë kritike u llogaritën veçmas më lart.

Tabela 12: Individë në situatë kritike dhe në nevojë për shërbime

Njësia administrative	INDIVIDË NË SITUATË KRITIKE									
	Përfitues NE	AK dhe Invalidë pune	Fëmijë	Gra	Të moshuar	Të papunë	Romë Egjyptianë	Të rinj	Gjithsej	Në %
Berat	107	2.112	348	1.739	463	231	217	277	5.494	72
Velabisht	42	282	29	141	87				581	8
Otlak	103	318	31	149	83				684	9
Sinjë	174	150	11	89	187				611	8
Rroshnik	62	121	4	55	54				296	4
Gjithsej	488	2.983	423	2.173	874	231	217	277	7.666	100
Në përqindje	6	39	6	28	11	3	3	4	100	
Përfitojnë shërbime aktualisht	245	60	66	41	70		219	141	842	
Në % ndaj numrit të përgjithshëm të individëve në nevojë	50	2	16	2	8	0	100	51	11	
Individë në nevojë për shërbime	243	2.923	357	2.132	804	231	0	136	6.824	
Në %	4	43	5	31	12	3	0	2	100	

Burimi: Zyra për Shërbimet Shoqërore, Bashkia Berat, Maj 2026

Analiza e grupeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, identifikoi faktin se në territorin e Bashkisë Berat janë 6.824 individë, që kanë të nevojshëm të paktën një formë të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Individët me aftësi të kufizuar përbëjnë grupin më kritik (43%) në raport me nevojën për shërbime, pasuar nga grupi “Gra” (31%); Të moshuar (12%); “Fëmijët”, 5%; “Individë në nevojë ekonomike”(4%); Të papunët (3%) dhe të Rinjtë, 2%.

Tabela 13: Përmbledhje e individëve në nevojë për shërbime të identifikuar në raport me numrin e popullsisë

NJËSIA ADMINISTRATIVE	NR.POPULLSIE	NR. INDIVIDË NË NEVOJË PËR SHËRBIME KUJDESI SHOQEROR	%
-----------------------	--------------	--	---

Berat	59.428	4.652	8
Velabisht	11.100	581	5
Otlak	13.032	684	5
Sinjë	4.478	611	14
Rroshnik	2.839	296	10
Gjithsej	90.877	6.824	7.5

Burimi: Bashkia Berat, Maj 2026.

Siç tregon tabela 7.5% e popullsisë është në nevojë për shërbime. Përqindja e personave në nevojë në Sinjë është shumë më e madhe se sa mesatarja e bashkisë, në Rroshnik është gjithashtu tepër e lartë, në Berat është pak më e lartë se sa mesatarja e bashkisë, ndërsa në Velabisht dhe Otlak është më e ulët se sa mesatarja e bashkisë, 2.5 pikë përqindje.

E gjithë analiza dukshëm argumenton renditjen si vijon të grupeve mbështetur në analizën sasiore të të dhënave:

1. Individë me AK dhe Invalidë pune
2. Gra në kushte kritike
3. Të moshuar
4. Fëmijë në kushte kritike
5. Përfitues NE
6. Të papunë
7. Të rinj

5. Vlerësimi cilësor I nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror

Mbështetur në Udhëzimin² si edhe metodologjinë e ndërtuar për identifikimin e grupeve më në nevojë kritike dhe formulimin e objektivave strategjike të Planit Social, u realizua edhe vlerësimi cilësor I nevojave, nëpërmjet Pyetsorit 2 si instrument I vlerësimit (Shtojcë 1), rezultatet e të cilit paraqiten tek Tabela 15.

Tabela 14: Grupet më të përjashtuara dhe nevojat më kritike të tyre.

Grupet më të përjashtuara sipas prioritetit	Nevojat më kritike
1. Të rritur AK dhe invalidë pune	Mungesa e shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese, mungesë e trajtimit shëndetsor.
2. Fëmijë AK dhe fëmijë të tjerë në nevojë për mbrojtje	Mungesa e shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese, mungesë e trajtimit shëndetsor.
3. Gra të vetme, të papuna	Papunësia, nevoja për riintegrim

² Guide for Local Social Plan in Albania, Shkurt 2025

4. Të moshuar të vetmuar	Vështirësi në trajtimin shëndetsor, braktisja
5. Individë të familjeve në nevojë kritike ekonomike	Mungesa e të ardhurave e shkaktuar kryesisht nga ppaunësia.

Pjesa e dytë e pyetsorit synonte identifikimin e shërbimeve më të nevojshme për grupet më të përjashtuara ose në rrezik përjashtimi. Përpunimi i të dhënave tregoi se “Shërbimet në familje” konsiderohen si shërbimi më kritik për bashkinë Berat. Rezultatet janë përmbledhur tek Tabela 16.

Tabela 15: Shërbimet më të nevojshme në bashkinë Berat.

Shërbimet më të nevojshme sipas prioritetit	Grupi përfitues
1. Shërbime në familje.	Të rritur me AK dhe Invalidë pune, Fëmijë AK, Të moshuar
2. Shërbime në qendër ditore	Fëmijë AK, Të moshuar
3. Shërbime të specializuara	Fëmijë dhe të rritur AK
4. Shërbime në qendër rezidenciale	Të rritur me AK dhe invalidë pune.
5. Shërbime komunitare	Të varfër, të papunë, të rinj në nevojë për riintegrim.

Diskutimet me grupet e interesit përcaktuan prioritetet si vijojnë:

1. Ndërtim dhe funksionim i modelit të shërbimeve në familje për të moshuar, të rritur me AK dhe invalidë pune, si edhe fëmijë me aftësi të kufizuar.
2. Ndërtim dhe funksionim qendër rezidenciale për individë të rritur me AK dhe invalidë pune.
3. Organizim shërbime në qendër ditore dhe komunitare për gratë të vetme, pa të ardhura dhe të papuna, individë të familjeve përfituese të NE, të rinj në nevojë për riintegrim, të papunë, si edhe për fëmijë në nevojë për mbrojtje, përfshirë fëmijë me AK të lehtë ose të moderuar.

Duke ju referuar shportës së shërbimeve shërbimeve të kujdesit shoqëror në përputhje me ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”³, nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror prezantohen në tabelën 19.

³ *Aksesuar nga*

<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20132/VKM%20nr.%20518,%20date%204.9.2018.pdf>



Tabela 16. Individët në nevojë dhe tipet e shërbimeve të mundshme sipas shportës së shërbimeve

INDIVIDE NË NEVOJË PËR SHËRBIME	BASHKIA	TIPET E SHËRBIMEVE SIPAS SHPORTËS
Individë mbi 18 vjeç përfitues të ndihmës ekonomike	243	1. Program për fuqizimin ekonomik.
Fëmijë në situatë kritike, me aftësi të kufizuar dhe në nevojë për mbrojtje	357	1. Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line, shërbim i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës 2. <i>Shërbime rehabilituese per personat në nevojë për aftësim fizik</i>
Të rritur me aftësi të kufizuar dhe invalidë pune	2.923	1. Shërbime rehabilituese per personat në nevojë për aftësim fizik;
Të moshuar të vetmuar	804	1. <i>Shërbimet në familje për të moshuar të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal.</i> 2. <i>Qendra ditore për të moshuarit;</i>
Të papunë	231	
Të rinj në nevojë	136	1. Program për fuqizimin ekonomik.
Gra të vetme me fëmijë, në nevojë për mbrojtje	2.132	1. <i>Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line, shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;</i> 2. <i>Shërbimi i emergjencës 72 orë, per viktimat të dhunës në familje dhe fëmijët që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situate që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur.</i>

		3.Shërbimi i strehimit të mbrojtur viktimat e dhunës në familje.
Gjithsej	6.824 7.5% e popullsisë	



6. Fushat strategjike në të cilat duhet të ndërhyjë bashkia nëpërmjet Planit Social 2027-2030

6.1. Prioritetet, qëllimi dhe objektivat

Prioritet 1: Ndërtim dhe funksionim i modelit të shërbimeve në familje për të moshuar, të rritur me AK dhe invalidë pune, si edhe fëmijë me aftësi të kufizuara.

Prioritet 2: Ndërtim dhe funksionim qendër rezidenciale për individë të rritur me AK dhe invalidë pune.

Prioritet 3: Organizim shërbime në qendër ditore dhe komunitare për gratë të vetme, pa të ardhura dhe të papuna, individë të familjeve përfituese të NE, të rinj në nevojë për riintegrim, të papunë, si edhe për fëmijë në nevojë për mbrojtje, përfshirë fëmijë me AK të lehtë ose të moderuar.

Qëllimi Strategjik: Të sigurohet mbrojtje dhe mbështetje e specializuar për grupet më të përjashtuara, me synim përmirësimin e mirëqenies, autonomisë dhe përfshirjes së tyre sociale, nëpërmjet zhvillimit të një sistemi të qëndrueshëm të shërbimeve të kujdesit social, që garanton akses të barabartë në shërbime sociale të integruara dhe cilësore në familje, në komunitet dhe në situata emergjence.

Objektivat:

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social me bazë familjen dhe komunitetin për grupet në nevojë, nëpërmjet ndërtimit dhe funksionimit të modelit të shërbimeve në familje për të moshuar, fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara.

Objektiv Specifik 1: Organizimi i shërbimeve në familje për të moshuar

Objektiv Specifik 2: Organizimi i shërbimeve në familje për individë me AK

Objektivi Specifik 3: Rritja e kapaciteteve të bashkisë dhe partnerëve të saj për ofrimin e shërbimeve cilësore.

Objektivi Strategjik 2: Forcimi i mekanizmave vendorë të kujdesit social për personat mbi 21 vjeç, me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, integruar dhe gjithëpërfshirës, në përputhje me nevojën e tyre.

Objektivi Specifik 1: Ndërgjegjësimi i grupeve të interesit për krijimin e një mjedisi mbrojtës, zhvillues dhe gjithëpërfshirës për të rriturit mbi 21 vjeç me aftësi të kufizuara.

Objektivi Specifik 2: Ngritja e një qendre rezidenciale për sigurimin e shërbimeve të specializuara për të rritur mbi 21 vjeç, me aftësi të kufizuara

Objektivi strategjik 3: Zhvillimi i shërbimeve mbështetëse, zhvilluese dhe ri-integruese në qendrat ditore dhe komunitare për gra, fëmijë, të rinj, të papunë dhe individë të familjeve në NE, të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi.

Objektivi Specifik 1: Rritja e aksesit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve mbështetëse, zhvilluese dhe psiko-sociale në qendrat ditore dhe komunitare për gratë, fëmijët, të rinjtë, të papunët dhe individët e familjeve në nevojë ekonomike ose në rrezik përjashtimi social.

Objektivi Specifik 2: Fuqizimi social dhe ekonomik dhe riintegrimi në komunitet i individëve dhe familjeve në nevojë, nëpërmjet programeve të zhvillimit të aftësive, orientimit profesional, ndërmjetësimit për punësim dhe mbështetjes për përfshirje aktive në jetën komunitare.

6.2.Kosto e përgjithshme e Planit të Shërbimeve Sociale, 2027-2030

Tabela 17: Kosto e përgjithshme e planit social, lekë

Objektivat strategjike dhe specifike	Kosto e përgjithshme	Periudha/Viti			
		2027	2028	2029	2030
Objektiv Strategjik 1	52.260.000	6.180.000	15.360.000	15.360.000	15.360.000
Obj.Sp. 1.1	21.000.000	3.000.000	6.000.000	6.000.000	6.000.000
Obj.Sp.1.2	21.000.000	3.000.000	6.000.000	6.000.000	6.000.000
Obj.Sp.1.3	10.260.000	180.000	3.360.000	3.360.000	3.360.000
Objektiv Strategjik 2	18.353.000	1.650.000	10.770.000	2.966.500	2.966.500
Obj.Sp. 2.1	2.560.000	250.000	770.000	770.000	770.000
Obj.Sp.2.2	15.793.000	1.400.000	10.000.000	2.196.500	2.196.500
Objektiv Strategjik 3	5.860.000	650.000	1.220.000	3.220.000	770.000
Obj.Sp. 3.1	960.000	150.000	270.000	270.000	270.000
Obj.Sp.3.2	4.900.000	500.000	950.000	2.950.000	500.000
Gjithsej	76.473.000	8.480.000	27.350.000	21.546.500	19.096.500



7. Plani i veprimit

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social me bazë familjen dhe komunitetin për grupet në nevojë, nëpërmjet ndërtimit dhe funksionimit të modelit të shërbimeve në familje për të moshuar, fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, si dhe familje në varfëri.

Kosto e përgjithshme e Objektivit 1 : 52.260.000 lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO
Objektivi specifik 1.1: Organizimi i shërbimeve në familje për të moshuar në nevojë për mbrojtje Përfitues: 50 të moshuar në nevojë për mbrojtje Kosto e Objektivit Specifik 1.1: 21.000.000 për të gjithë periudhën e veprimit të planit. Baza ligjore: Plani Kombëtar mbi Moshimin, Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë.				
1.1.1. Identifikimi i të moshuarve dhe vlerësimi i nevojave të tyre.		3m I 2027		Pa kosto
1.1.2. Hartimi i praktikave të		3m II 2027		Shpenzime për hartimin e praktikave: Grup ekspertësh (2) për 25 ditë

shërbimit dhe manualeve përkatës dhe kualifikim I stafit	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore		Bashkia nga “Të ardhura të vetat” Bashkia nga “Fondet e Pakushtëzuara” Bashkia nga “Fondi Lokal Social dhe Fondi qendror social”.	2*25 ditë*Lekë20.000/ditë Lekë 1.000.000 Shpenzime për trainim stafi (2 trainime, secili 5 ditë): 10 ditë *20 persona*10,000 lekë në ditë=2.000.000 (është përfshirë edhe kosto për 2 trainerët). Kosto e plotë për aktivitetin 3.000.000 lekë
1.1.3. Përzgjedhja e një ekipi prej 5 punonjësish që do të organizojnë shërbimin.		6 m II 2027		Pa kosto
1.1.4. Sigurimi i shërbimit në familje për 50 persona, 2 herë në javë, nga një grup prej 5 personash.		2028 2029 2030		Shpenzime për paga: 5 persona*70,000lekë/muaj*12 muaj =4.200.000 në vit Shpenzime për trajtimin e të moshuarve (artikuj higjenike, argëtim, kafe.fruta etj): 50*3,000 lekë në muaj*12 muaj = Lekë 1.800.000 lekë në vit. Shpenzime vjetore gjithsej: 6.000.000 lekë. Kosto e plotë për aktivitetin gjatë periudhës 2028-2030 (3 vite) 3*6.000.000=18.000.000 lekë.
Objektivi specifik 1.2: Organizimi i shërbimeve në familje për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar.				
Përfitues: 30 fëmijë dhe 20 të rritur me aftësi të kufizuar				

Kosto e Objektivit Specifik 1.2: 21.000.000 për të gjithë periudhën e veprimit të planit.

Baza ligjore: Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, “Statusi i invalidit ”, Ligj Nr.18/2017 “Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 “ Për përcaktimin e rregullave të menaxhimit të rasteve, koordinimit, referimit....”.

1.2.1. Identifikimi i fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuar dhe vlerësimi i nevojave të tyre, si edhe identifikimi sipas njësive administrative.	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore NjMF Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore	3m I 2027	Bashkia nga “Të ardhura të vetat” Bashkia nga “Fondet e Pakushtëzuara” Bashkia nga “Fondi Lokal Social dhe Fondi qendror social”.	Pa kosto
1.2.2. Hartimi i praktikave të shërbimit dhe manualeve përkatës dhe kualifikim i stafit	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore NjMF	3m II 2027		Shpenzime për hartimin e praktikave: Grup ekspertësh (2) për 25 ditë 2*25 ditë*Lekë20.000/ditë Lekë 1.000.000 Shpenzime për trainim stafi (2 trainime, secili 5 ditë): 10 ditë *20 persona*10.000 lekë në ditë=2.000.000 (është përfshirë edhe kosto për 2 trainerët). Kosto e plotë për aktivitetin 3.000.000 lekë

1.2.3. Përzgjedhja e një ekipi prej 5 punonjësish që do të organizojnë shërbimin.	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore	6m II, 2027		Pa kosto
1.2.4. Sigurimi i shërbimit në familje për 50 persona, 1 herë në javë, nga një grup prej 5 personash.	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore	2028 2029 2030		Shpenzime për paga: 5 persona*70,000lekë/muaj*12 muaj =4.200.000 në vit Shpenzime për trajtimin e përfituesve (materiale higjenike, didaktike dhe argëtuese): 50*3.000 lekë në muaj*12 muaj = Lekë 1.800.000 lekë në vit. Shpenzime vjetore gjithsej: 6.000.000 lekë. Kosto e plotë për aktivitetin gjatë periudhës 2028-2030 (3 vite) 3*6.000.000=18.000.000 lekë.
Objektivi specifik 1.3: Rritja e kapaciteteve të bashkisë dhe partnerëve të saj për ofrimin e shërbimeve cilësore Përfitues: 20 punonjës të bashkisë, sektori i shërbimeve sociale, 10 ofrues të shërbimeve sociale jashtë bashkisë Kosto e objektivit specifik 1.4: 10.260.000 lekë për të gjithë periudhën Baza ligjore: Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 “ Për përcaktimin e rregullave të menaxhimit të rasteve, koordinimit, referimit....”.				
1.3.1.Rritje e numrit të punonjësve socialë				Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore për 5 punonjës: 5

me pesë punonjës, nga një për secilën njësi.	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore	2027 (pa kosto) 2028 2029 2030	Bashkia nga “Të ardhura të vetat” Bashkia nga “Fondet e Pakushtëzuara” Bashkia nga “Fondi Lokal Social dhe Fondi qendror social”.	punonjës*50.000lekë në muaj*12 muaj =3.000.000 lekë në vit. Kosto e plotë për periudhën 2028-2030: 9.000.000 lekë
1.3.2. Ndërtimi i bazës të të dhënave të operatorëve të shërbimeve sociale, publikë dhe jo publikë.		6mII 2027		Pa kosto
1.3. 3.Organizim kurs formimi dhe riformimi profesional për të gjithë punonjësit e bashkisë që operojnë me çështjet e shërbimeve sociale.(kurs 3 ditor, çdo vit)		2027 2028 2029 2030		4 kurse gjithsej 8 lektorë në secilin kurs 20 pjesëmarrës Kosto 1 kurs:180.000 lekë /vit, Kosto e plotë për 2027-2030: 720.000 lekë
1.3.4. Program trainimi “Rritja e fondeve nëpërmjet hartimit dhe menaxhimit të projekteve”		2028 2029 2030		3 kurse për 3 vite (2028-2030) 6 lektorë në secilin kurs 20 pjesëmarrës Kosto 1 kurs:180.000 lekë Kosto e plotë për 2028-2030: 540.000lekë

Objektivi Strategjik 2: Forcimi i mekanizmave vendorë të kujdesit social për personat mbi 21 vjeç, me aftësi të kufizuar, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, integruese dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me nevojën e tyre.

Kosto e përgjithshme e Objektivit 2: 18.353.000 lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO
Objektivi specifik 2.1: Ndërgjegjësimi i grupeve të interesit për krijimin e një mjedisi mbrojtës, zhvillues dhe gjithëpërfshirës për të rriturit mbi 21 vjeç me aftësi të kufizuara. Përfitues: 200 individë me AK, mbi 21 vjeç. Kosto e Objektivit Specifik 2.1: 2.560.000 lekë për të gjithë periudhën e veprimit të planit. Baza ligjore: Ligji Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, Ligj nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 “ Për përcaktimin e rregullave të menaxhimit të rasteve, koordinimit, referimit....”.				
2.1.1. Identifikimi i individëve mbi 21 vjeç, me AK. Ndërtimi i bazës të të dhënave duke i klasifikuar individët me AK mbi 21 vjeë, sipas nevojës.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale	3m I 2027	Bashkia nga të ardhurat e veta	Pa kosto
2.1.2 Nxitja e partneriteteve Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet bashkisë, bizneseve, zyrës së punësimit dhe OJF-ve, si edhe universitetit të Korçës	Drejtoria e Shërbimeve Sociale	6m II 2027 2028	Bashkia nga të ardhurat e veta	Pa kosto

2.1.3.. Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese mbi të drejtat dhe potencialin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale	6mll 2027 2028	Bashkia nga të ardhurat e veta	Pa kosto
2.1.4 Organizimi i tryezave të rrumbullakëta me bizneset lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet publike.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale Shoqatat që mbrojnë të drejtat e individëve me AK Universiteti i Korçës	2027 2028 2029 2030		Kosto vjetor: 150.000 lekë Kosto e plotë e aktivitetit: 600.000 lekë
2.1.5 Zhvillimi i ditëve të hapura ose forumeve "Biznesi gjithëpërfshirës". Organizimi i aktiviteteve në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara (3 Dhjetor).	Drejtoria e Shërbimeve Sociale Universiteti i Korçës Zyra e Shërbimeve të Punësimit Shoqata për të drejtat e individëve me AK	2027 2028 2029 2030	Fondi Social Lokal Fondi Social Kombëtar	Kosto vjetore: 100.000 lekë Kosto e plotë e aktivitetit: 400.000 lekë
2.1.6 Informimi i bizneseve nëpërmjet përgatitjes dhe shpërndarjes të materialeve informuese mbi përfitimet e punësimit të personave me AK, skemat shtetërore të subvencionimit të punësimit dhe lehtësitë fiskale, prezantimi i modeleve të	Drejtoria e Shërbimeve Sociale Zyra e Punësimit	2028 2029 2030	Bashkia, Të ardhurat e veta Zyra e Punësimit	Kosto vjetore: 120.000 lekë (vetëm për materialet informuese) Kosto e plotë e aktivitetit: 360.000 lekë

suksesshme të bizneseve që punësojnë persona me AK.				
2.1.7 Nxitja e punësimit dhe praktikave profesionale nëpërmjet organizimit të panairëve lokale të punës gjithëpërfshirëse;	Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki Zyra e Punësimit	2028 2029 2030	Bashkia, Të ardhurat e veta Zyra e Punësimit	Kosto vjetore: 200.000 lekë (vetëm për materialet informuese) Kosto e plotë e aktivitetit: 600.000 lekë
2.1.8 Promovimi dhe njohja e praktikave të mira nëpërmjet krijimit të në çmimi vjetor "Biznesi Gjithëpërfshirës"; Publikimit të historive të suksesit të punëdhënësve dhe punëmarrësve me AK; Promovimi i praktikave të mira në mediat lokale dhe rrjetet sociale.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale Universiteti i Korçës Zyra e Shërbimeve të Punësimit	2028 2029 2030	Bashkia, Të ardhurat e veta Fondi Lokal Social	Çmimi "Biznesi gjithëpërfshirës" 100.000 lekë në vit Materiale promovuese: 50.000 lekë në vit Kosto operacionale: 50.000 lekë në vit Kosto vjetore e aktivitetit: 200.000 lekë në vit Kosto e plotë e aktivitetit: 600.000 lekë në vit.
Objektivi specifik 2.2: Ngritja e një qendre residenciale për sigurimin e shërbimeve të specializuara për të rritur mbi 21 vjeç, me aftësi të kufizuar. Përfitues: 50 individë mbi 21 vjeç, me AK të rëndë. Kosto e Objektivit Specifik 2.2: 15.793.000 lekë për të gjithë periudhën e veprimit të planit. Baza ligjore: Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 " Për përcaktimin e rregullave të menaxhimit të rasteve, koordinimit, referimit....".				
2.2.1 Identifikimi i partnerëve të mundshëm për financimin dhe mbështetjen e qendrës		3ml 2027	Bashkia nga të ardhurat e veta	Pa kosto

	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore			
2.2.2. Përgatitja projekt propozim dhe paraqitje tek donatorët.	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore	2027	Bashkia nga të ardhurat e veta	Pa kosto
2.2.3.Miratimi i projektit në Këshillin Bashkiak	Këshilli Bashkiak	6mII 22027		Pa kosto
2.2.4. Sigurimi i financimit, nënshkrimi i marëveshjes	Kryetari i bashkisë	6mII 2027		Pa kosto
2.2.5.Përzgjedhja e stafit dhe/ose kualifikimi	Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me donatorin	2027	Bashkia nga të ardhurat e veta Donatori/Financuesi i Strehëzës (UNDP, UNICEF, EU)	Program i plotë kualifikimi (1 javë, 20 persona, specialistë të shërbimeve sociale, specialistë të trajtimit të rasteve të emergjencës, specialistë të mbrojtjes dhe sigurisë). Kosto e programit të trainimit: 1.000.000lekë

2.2.6. Hartimi i rregulloreve dhe standarteve të shërbimeve Hartimi i manualeve operacionale		2027	Donatori/Financuesi i Strehëzës (UNDP, UNICEF, EU)	Kosto ekspertizë teknike: 1 ekspert*20.000lekë/ditë*20 ditë=400.000lekë
2.2.7. Ndërtimi i qendrës, përgatitja e kushteve për funksionimin e saj		2028	Donatorë	Kosto investimit: 10.000.000 lekë
2.2.8.Funksionimi i qendrës		2029 2030	Bashkia nga fondi social kombëtar dhe lokal	Kosto operacionale për periudhën 2029 dhe 2030: 2.196.500 lekë secili vit. Kosto e plotë operacionale: 4.393.000
Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i shërbimeve mbështetëse, zhvilluese dhe ri-integruese në qendrat ditore dhe komunitare për gra, fëmijë, të rinj, të papunë dhe individë të familjeve në NE, të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi. Kosto e përgjithshme e Objektivit 3 : 5.860.000 lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit				
AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO
Objektivi specifik 3.1: Rritja e aksesit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve mbështetëse, zhvilluese dhe psiko-sociale në qendrat ditore dhe komunitare për gratë, fëmijët, të rinjtë, të papunët dhe individët e familjeve në nevojë ekonomike ose në rrezik përjashtimi social si edhe të moshuar të vetmuar, në nevojë riintegrimi				

Përfitues: 200 gra kryesisht kryefamiljare dhe në nevojë për mbrojtje, 50 të rinj të papunë, 50 përfitues të ndihmës ekonomike, 30 të papunë të tjerë, 30 të moshuar të vetmuar.

Kosto e Objektivit Specifik 3.1: 960.000 lekë për të gjithë periudhën e veprimit të planit.

Baza ligjore: Ligji Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 “ Për përcaktimin e rregullave të menaxhimit të rasteve, koordinimit, referimit....”.

3.1.1. Identifikimi i individëve nga grupet e mësipërme në kushte përjashtimi kritik	Drejtoria e Shërbimeve Sociale Zyra e Shërbimeve të Punësimit	3m I 2027	Bashkia nga të ardhurat e veta	Pa kosto
3.1.2 Zgjerimi i qendrave komunitare dhe ditore ekzistuese nëpërmjet rritjes së hapësirave për zgjerimin e aktiviteteve si edhe forcimi i kapaciteteve të stafit.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale Qendrat ekzistuese të shërbimeve sociale: Qendra Komunitare Multifunksional e, Qendra ditore për moshën e tretë, Qendra Rinore.	2027 2028 2029 2030	Bashkia nga të ardhurat e veta Mbështetj e nga donatorë	Kosto vjetor: 150.000 lekë Kosto e plotë e aktivitetit: 600.000 lekë
3.1.3 Informimi i grupeve të interesit, nëpërmjet përgatitjes dhe shpërndarjes të materialeve	Drejtoria e Shërbimeve Sociale	2028 2029 2030	Bashkia, Të	Pa kosto

informuese mbi zgjerimin e aktivitetit të qendrave ditore dhe komunitare.	Zyra e Punësimit		ardhurat e veta Zyra e Punësimit	
3.1.4 Ofrim i këshillimit psiko-social, ligjor dhe familjar; Ofrim shërbim për zhvillimin e aftësive për jetën dhe punën; vetë-punësim; riintegrim nëpërmjet punës dhe formimit profesional; Orientim dhe këshillim për punësim.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki Zyra e Punësimit	2028 2029 2030	Bashkia, Të ardhurat e veta Zyra e Punësimit	Kosto vjetore: 20.000 lekë (vetëm për materialet informuese) Kosto e plotë e aktivitetit: 60.000 lekë
3.1.5 Organizim aktivitete edukative, kulturore dhe rekreative përfshirë ato aktivitete që nxisin vetë-punësimin dhe promovojnë praktikën e mira të vetëpunësimit nëpërmjet sipërmarrjeve dhe biznesit social.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale Zyra e Shërbimeve të Punësimit	2028 2029 2030	Bashkia, Të ardhurat e veta Fondi Lokal Social	Kosto vjetore e aktivitetit: 100.000 lekë në vit Kosto e plotë e aktivitetit: 300.000 lekë .
Objektivi specifik 3.2: Fuqizimi social dhe ekonomik dhe riintegrimi në komunitet i individëve dhe familjeve në nevojë, nëpërmjet programeve të zhvillimit të aftësive, orientimit profesional, ndërmjetësimit për punësim dhe mbështetjes për përfshirje aktive në jetën komunitare. Përfitues: 50 gra kryefamiljare, 10 të rinj, 10 individë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, 10 të papunë, 10 të moshuar të vetmuar dhe aktivë. Kosto e Objektivit Specifik 3.2: 4.900.000 lekë për të gjithë periudhën e veprimit të planit.				

Baza ligjore: Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 " Për përcaktimin e rregullave të menaxhimit të rasteve, koordinimit, referimit....". Ligji për Sipërmarrjen Sociale Nr.65/2016.

3.2.1 Hartimi dhe promovimi i modeleve të sipërmarrjes sociale të përshtatshme për kushtet dhe potencialet ekonomike të bashkisë si: • mbështetje për vetëpunësim dhe sipërmarrje sociale; • mentorim dhe ndërmjetësim me bizneset; • programe vullnetarizmi dhe angazhimi komunitar.	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore Zyra e Shërbimeve të Punësimit	3mII 2027	Bashkia nga të ardhurat e veta	Pa kosto
3.2.2 Identifikimi i sektorëve me potencial për vetëpunësim, bazuar në burimet lokale dhe kërkesën e tregut (agropërpunim, artizanat, turizëm, shërbime, ekonomi digjitale, etj.).	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore Zyra e Shërbimeve të Punësimit	6m I 2027	Bashkia nga të ardhurat e veta	Pa kosto
3.2.3 Trajnime për sipërmarrjen dhe zhvillimin e biznesit, duke përfshirë: • hartimin e planit të biznesit; • menaxhimin financiar; • marketingun dhe shitjet; • tregtinë elektronike; • administrimin fiskal.	Zyra e Shërbimeve të Punësimit	6mII 2027 6m I 2028		5 kurse trainimi, për secilën nga tematikat, 50 pjesëmarrës secili. Kosto e një kursi: 200.000 lekë Kosto e të gjitha kurseve: 1.000.000 lekë

3.2.4 Program këshillimi individual për personat që dëshirojnë të krijojnë një biznes ose të vetëpunësohen; Mbështetja për hartimin e planeve të biznesit dhe përgatitjen e aplikimeve për financim; Ndërmjetësimi i partneriteteve ndërmjet sipërmarrjeve sociale dhe biznesit privat, për sigurimin e tregut dhe zinxhirit të furnizimit; Mbështetja për formalizimin e bizneseve të reja, duke ofruar informacion dhe asistencë mbi procedurat ligjore dhe fiskale.	Zyra e Shërbimeve të Punësimit Shoqatat e biznesit Qendrat e formimit profesional Drejtoria e Tatimeve dhe Taksave	2028 2029 2030		Vetëm kosto operacionale, spese ekspertiza do të ofrohet nga Zyra e Shërbimeve të Punësimit. Kosto operacionale për të gjithë aplikantët: 1.200.000 lekë për tre vite
3.2.5 Promovimi i kooperativave dhe formave të ekonomisë sociale, veçanërisht në zonat rurale.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me Shoqatat e biznesit dhe Median lokale	2028 2029	Bashkia nga të ardhurat e veta	Kosto vjetore: 50.000 lekë Kosto e plotë e aktivitetit: 100.000 lekë
3.2.6. Mbështetja e inkubatorëve ose hapësirave të përbashkëta të punës (co-working) për bizneset në fazat fillestare.		2029 2030 Shpenzimet do të bëhen në vitin 2029	Donatorë	Kosto e mbështetjes për një projekt: 500.000 lekë Numri i projekteve që mbështeten:5 Kosto e plotë e aktivitetit: 2.500.000 lekë

3.2.7. Ndjekja dhe monitorimi i iniciativave të mbështetura, për të identifikuar nevojat për asistencë shtesë dhe për të rritur qëndrueshmërinë e tyre.		2029 2030	Bashkia nga të ardhurat e veta.	Pa kosto
3.2.8 Promovimi i historive të suksesit, për të rritur motivimin dhe besimin në vetëpunësim.		2030	Bashkia nga të ardhurat e veta. Donatorë	Numri i programeve:5 (për secilin projekt fitues) Botime dhe fletë palosje, Media lokale. Kosto e plotë e aktivitetit: 100.000 lekë



8. Plani I Integruar I Monitorimit dhe Vlerësimit

Synimet e formulara sipas objektivave specifike të secilit objektiv të përgjithshëm.	Baza e nisjes e vlerësimit	Përfitues	Mënyra e vlerësimit	Treguesit e vlerësimit
Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social me bazë familjen dhe komunitetin për grupet në nevojë, nëpërmjet ndërtimit dhe funksionimit të modelit të shërbimeve në familje për të moshuar, fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara.	Viti 2026	20 Individë mbi 18 vjeç me AK dhe Invalidë, trajtim në familje. 30 fëmijë me AK 50 të moshuar. 20 punonjës të rinj dhe ekzistues të bashkisë. 10 punonjës të ofruesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.	Raport monitorimi nga ekipi i bashkisë, çdo 6 muaj. Raport vlerësimi nga ShSSH, Dega Korçë. Raport Vlerësimi përfundimtar nga ekipi i bashkisë si edhe ekspertëve të jashtëm, 6 muaj përpara përfundimit të afatit të planit, Prill-Qershor 2026	Numri i individëve që përfitojnë shërbime në familje. Niveli i kënaqshmërisë të përfituesve të shërbimit dhe familjërëve të tyre. Numri i punonjësve të shtuar, në Bashki për NjVNR në çdo njësi. Aktivizimi i sistemit MIS. Numri i kurseve të formimit dhe riformimit profesional për të gjithë punonjësit e bashkisë që operojnë me çështjet e shërbimeve sociale, si edhe sipas tematikave. Numri i pjesëmarrësve dhe sipas funksioneve.

Objektivi Strategjik 2: Forcimi i mekanizmave vendorë të kujdesit social për personat mbi 21 vjeç, me aftësi të kufizuar, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, integruese dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me nevojën e tyre.		200 individë mbi 21 vjeç, me aftësi të kufizuar të lehtë dhe të moderuar 50 individë mbi 21 vjeç, me aftësi të kufizuar të moderuar dhe të rëndë	Raport vlerësimi nga ShSSH, Dega Korçë. Raport Vlerësimi përfundimtar nga ekipi i bashkisë si edhe ekspertëve të jashtëm, 6 muaj përpara përfundimit të afatit të planit, Prill-Qershor 2030	Numri I bizneseve që punësojnë Individë me AK. Shkalla e ndërgjegjësimit të komuniteteve qytetare mbi nevojën e riintegritit të individëve me AK. Numri i personave që aksesojnë shërbimet e destinuar për individë mbi 21 vjeç me aftësi të kufizuar, sipas nevojës. Ndërtimi , funksionimi i Qendrës Residenciale. Shkalla e aksesimit nga qytetarët në nevojë kritike. Numri I personave të trajtuar në qendër.
Objektivi strategjik 3: Zhvillimi i shërbimeve mbështetëse, zhvilluese dhe ri-integruese në qendrat ditore dhe komunitare për gra, fëmijë, të rinj, të papunë dhe individë të familjeve në NE, të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi.	Viti 2026	200 gra në nevojë, kryesisht gra të vetme dhe kryefamiljare. 60 të rinj të papunë dhe/ose në konflikt me ligjin 60 individë në kushte kritike ekonomike, në familje me NE dhe familje të tjera.	Raport vlerësimi nga ShSSH, Dega Korçë. Raport Vlerësimi përfundimtar nga ekipi i bashkisë si edhe ekspertëve të jashtëm, 6 muaj përpara përfundimit të afatit të planit,	Shkalla e ndërgjegjësimit të grupeve të interesit, për realizimin e politikave aktive të punësimit për grupet më të përjashtuara ose në rrezik përjashtimi. Numri projekteve të vetë punësimit të mbështetura nëpërmjet

		40 të papunë të tjerë 10 të moshuar	Prill-Qershor 2030	biznesit dhe sipërmarrjes sociale, të realizuara. Numri i personave nga grupet e përjashtuara, të mbështetura nga projektet e sipërmarrjes sociale.
--	--	--	-----------------------	--

9. Vlerësimi i mundësisë së mbulimit të kostos të planit social 2027-2030

9.1. Analiza e shpenzimeve për mbrojtjen sociale në raport me të ardhurat e veta të bashkisë

Të ardhurat e bashkisë Berat përbëhen nga të ardhura nga burimet e veta si edhe të ardhura nga buxheti qendror. Këto të fundit përbëjnë edhe pjesën më të konsiderueshme, rreth 60%. Tabela 18 siguron informacion të detajuar mbi përbërjen e të ardhurave të bashkisë.

Tabela 18: Të ardhurat e bashkisë Berat (lekë)

Zërat e buxhetit	2023	2024	2025	2026
Të ardhura nga burimet e veta	437.830.988	466.126.381	532.164.970	232.639.910
Të ardhura nga taksat lokale	106.344,631	120,623,880	141,856,798	83,295,785
Të ardhura nga taksat e ndara (grante)	87,686,797	68,005,267	84,298,211	21,910,036
Të ardhura nga tarifa vendore	150,223,805	156,438,957	162,173,111	74,959,225
Të ardhurat e tjera	93,575,754	121,058,277	143,836,850	52,474,864
Të ardhura nga buxheti qendror	1.624.981.647	1,558,204,654	1,573,781,532	1,225,912,000
Transferta e kushtëzuar	478,535,913	482,624,679	463,172,688	235,246,250
Transferta e pakushtëzuar	432,253,651	493,355,048	576,626,865	545,223,749
Për funksionet e deleguara	16,904,618	11,887,000	24,543,250	10,472,200
Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	389,383,952	244,329,196	138,348,007	72,898,749
Transf. e Përgjithshme Sektoriale	307,903,513	326,008,732	371,090,722	362,071,053
Trashëgimi nga Viti i shkuar	212,673,236	196,764,212	169,848,327	186,036,339
Trashëgimi pa destinacion	210,563,838	194,925,099	168,432,325	185,217,786
Trashëgimi me destinacion	2,109,398	1,839,113	1,416,002	818,553

Totali i burimeve buxhetore	2,275,485,871	2,221,095,248	2,275,794,829	1,644,588,250
------------------------------------	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------

Burimi: Drejtoria e Buxhetit, Bashkia Berat, 2026

Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë gjatë periudhës që analizohet kanë ndryshuar me ritme jo të qëndrueshme, sidomos në vitin 2026, vit në të cilin janë rreth 50% më të larta se sa në vitin 2023. (Tabela 18).

Buxheti i mbrojtjes shoqërore përbën rreth 40% të buxhetit të bashkisë (Tabela 19). Siç konstatohet nga të dhënat e tabelës 19, së pari, shpenzimet për mbrojtjen shoqërore janë zvogëluar, me përjashtim të vitit të fundit, vit në të cilin vetëm 6 mujori i parë është sa 70% e shpenzimeve të viteve paraardhëse; së dyti, shpenzimet ndërmjet zërave nuk duken të jenë proporcionale, së treti, zëri “Shërbime të Kujdesit social” mungon, gjë që dëshmon se bashkia ende nuk i konsideron shërbimet sociale si detyrim të politikave të saj.

Tabela 19: Buxheti i mbrojtjes dhe kujdesit shoqëror, 2023-2026 (lekë).
Viti 2026 është shifra vetëm 6mujorin e parë.

Programet	2023	2024	2025	2026
Sëmundje dhe paaftësi	428.530.793	428.389.000	398.287.852	202.461.720
Arsim (baze dhe parashkollor, + parauniversitar)	339.773.333	359.480.303	296.891.602	269.247.337
Të moshuarit	-		-	-
Familja dhe fëmijë	1.164.000	1.164.000	1.164.000	1.164.000
Papunësia	-		-	-
Strehimi	74.049.670	42.141.950	37.114.295	35.682.162
Ndihma ekonomike	49.479.000	51.029.000	48.827.000	19.553.000
Totali	892.996.796	882.204.253	782.284.750	528.108.219

Burimi: Drejtoria e Buxhetit, Bashkia Berat, 2026

Përveç buxhetit të financuar nga të ardhurat e veta dhe nga buxheti qendror, bashkia Berat është mbështetur financiarisht nga Fondi social dhe nga burime të tjera, përkatësisht siç tregohet tek tabela 20.

Tabela 20: Projektet e mbështetura nga burime të tjera në bashkinë Berat.

Projekti	Shuma e përgjithshme	2023	2024	2025	2026
Strehëza emergjente	4.656.000	1.164.000	1.164.000	1.164.000	1.164.000
Shuma lekë	4.656.000	1.164.000	1.164.000	1.164.000	1.164.000

Burimi: Drejtoria e buxhetit, bashkia Berat, 2026

Edhe pse buxhetet e financuara nga burime të tjera përbëjnë vetëm 0.1% të buxhetit të përgjithshëm të mbrojtjes shoqërore, ato përsëri kanë ndihmuar për të realizuar aktivitete të qënësishme dhe siguruar shërbime efektive dhe cilësore për qytetarët e Beratit.

Shpenzimet e përgjithshme vetëm për mbrojtjen shoqërore, të realizuara nga burimet e bashkisë dhe nga burime të tjera paraqiten tek tabela 21.

Tabela 21: Shpenzimet e përgjithshme vetëm për mbrojtjen shoqërore (mijë lekë)

Programet	2023	2024	2025	2026
Mbrojtja Shoqërore	544.791	553.954	518.351	302.660
Shërbime sociale	77.952	49.720	47.129	40.845
Gjithsej	622.743	603.674	565.480	343.505

Burimi: Drejtoria e buxhetit, bashkia Berat, Maj 2026

Shpenzimet e mbrojtjes shoqërore në raport me të ardhurat e përgjithshme të bashkisë përgjatë katër viteve të fundit kanë përbërë mesatarisht 30 deri 40%, me një tendencë rritjeje në vitin e fundit, siç tregon tabela 21.

Në tabelë vihet re se të ardhurat thuajse nuk kanë ndryshuar, me përjashtim të vitit të fundit, në të cilin janë rritur ndjeshëm, gjë që ka ndikuar në rritjen e peshës së shpenzimeve për mbrojtjen shoqërore përkundrejt të ardhurave (tabela 21).

Tabela 22: Shpenzimet e kujdesit shoqëror kundrejt totalit të ardhurave, mijë lekë, 2023-2026 (Viti 2026 është shifra 6 mujorit parë)

Periudha	2023	%	2024	%	2025	%	2026	%
Shpenzimet e përgjithshme për mbrojtjen shoqërore përfshirë të ardhurat nga projektet	622.743	100	603.674	99	565.480	88	343.505	101
Të ardhurat e përgjithshme	2.275.487	100	2.221.096	96	2.275.795	100	1.644.588	144

Shpenzimet/ Ardhurat %	28		28		26		40	
------------------------------	----	--	----	--	----	--	----	--

Burimi: Bashkia Berat, të dhëna mbi buxhetin vjetor, Maj 2026.

9.2. Analiza e mundësive për financimin e planit social, sipas PBA 2027-2030.

Sipas PBA 2027-2030 (Tabela 23) shpenzimet për mbrojtjen shoqërore parashikohen të rriten në mënyrë të qëndrueshme. Edhe pse zëri “shërbime sociale” ende nuk paraqitet në PBA, përsëri kjo nuk përjashton mundësinë e financimit të tyre, nga të ardhurat e vetë bashkisë, nga transfertat e pakushtëzuar si edhe nga fondi social ose donatorë të tjerë.

Tabela 23: Shpenzimet e bashkisë për Programin e Mbrojtjes Sociale, sipas PBA 2027-2030 (mijë lekë)

Kodi	Programi	2027	2028	2029	2030
10	Mbrojtja Sociale	162.400	186.320	171.347	
	Në % ndaj totalit të shpenzimeve	9	11	9	
101	Sëmundje Paaftësi	34.066	34.720	35.610	
	Në % ndaj totalit të shpenzimeve	2	2	2	
104	Familje Fëmijë	101.744	123.930	106.881	
	Në % ndaj totalit të shpenzimeve	6	7	5	
106	Strehim Social	24.590	24.670		
	Në % ndaj totalit të shpenzimeve	1	1		
	Shpenzime gjithsej	1.718.834	1.752.229	1.974.401	

Burimi: Bashkia Berat, PBA 2026

Për të realizuar qëllimin strategjik të planit social si edhe objektivat specifike të tij, bashkia duhet të realizojë një listë të mirë detajuar të aktiviteteve, kostoja e përgjithshme e të cilave llogaritet 76.473 mijë lekë për katër vite.

Për të vlerësuar mundësitë e buxhetimit të planit social, konsiderojmë disa faktorë:

1. Të Ardhurat Vjetore mesatare të bashkisë 2023-2026 janë 2.450.000 mijë lekë.
2. Meqenëse nuk supozojmë dot rritje, do të supozojmë se të ardhurat e bashkisë do të jenë të pandryshueshme, të barabarta me nivelin mesatar të tyre, 2.450.000 mijë lekë, edhe për periudhën, për të cilën është hartuar Plani I Kujdesit Social, 2027-2030.
3. Aplikojmë të njëjtin arsyetim për pjesën e të Ardhurave të Bashkisë që sigurohen nga burimet e veta, pra të Ardhurat e Veta dhe konstatojmë se të Ardhurat e veta në periudhën 2023-2026 kanë qenë afërsisht të njëjta, mesatarisht 475.000 mijë lekë.
4. Supozojmë se të Ardhurat e Veta do të vazhdojnë të mos ndryshojnë, të barabarta me nivelin mesatar të tyre, 475.000 mijë lekë.
5. Transfertat e pa kushtëzuara gjithashtu nuk kanë ndryshuar në mënyrë proporcionale. Supozojmë se do të jenë në masën 512.000 mijë lekë periudhën pasardhëse.

6. Shpenzimet e planifikuara për mbrojtjen sociale në periudhën 2027-2030 supozojmë se shpenzimet për mbrojtjen shoqërore do të vijojnë të jenë të njëjta me shpenzimet e vitit 2026, rreth 600.000 lekë.
7. Rezultatet e llogaritjeve mbi bazën e të dhënave dhe supozimeve të paraqitura në pikat 1 deri 5, I përmbledhim në tabelën në vijim.

Tabela 24: Kosto e Planit Social përballë të Ardhurave të bashkisë (mijë lekë).

Emërtimet e programeve	2027	2028	2029	2030
Kosto e Planit Social	8.480	27.350	21.547	19.100
Shpenzimet e mbrojtjes sociale plan	600.000	600.000	600.000	600.000
Të ardhurat gjithsej të bashkisë të pritshme	2.450.000	2.450.000	2.450.000	2.450.000
Të ardhurat e veta të pritshme	475.000	475.000	475.000	475.000
Në % ndaj të Ardhurave gjithsej	0.4	1.3	1	0.9
Në % ndaj të ardhurave të veta	1.9	6	4.5	4
Në % ndaj shpenzimeve për mbrojtje shoqërore	1.3	4.5	3.5	3

Burimi: PBA Bashkia Berat, 2026

Analiza e të dhënave të tabelës 24 konfirmon se:

Nëse konsiderohen vetëm llogaritjet, kosto e planit social është e përballueshme nga buxheti i bashkisë. Megjithatë bashkia ka zëra të tjera të shpenzimeve të cilat duhet të mbulohen pavarësisht planit të kujdesit social. Bashkia duhet të analizojë me kujdes drejtimit e përdorimit të të ardhurave të veta për të gjykuar nëse mund të financohet të paktën pjesërisht Plani Social për secilin vit, edhe pse PBA për periudhën 2027-2030 është përgatitur tashmë.

Analiza duhet të përfshijë edhe të ardhurat e financuara nga transfertat e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara, të cilat duhet të jenë objekt diskutimi në Këshillin Bashkiak si edhe ndërmjet Këshillit Bashkiak dhe Ministrisë së Financave dhe Partnerëve të tjerë institucionalë të bashkisë.

Në këto kushte, duket e vështirë të sigurohet financimi i Planit Social nga Buxheti i bashkisë. Çështja e financimit të Planit Social duhet të trajtohet si një çështje jo vetëm e bashkisë, pavarësisht kompetencave që I jep ligji Bashkisë. Çështja e financimit të planit social është e lidhur drejtëpërsëdrejti me forcimin e sistemit të shërbimeve sociale në përputhje me Dokumentin Politik të Përfshirjes Sociale si edhe Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen shoqërore.

9.3.Rekomandime për mirë planifikimin e shpenzimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë Berat

- ✓ Bashkia Berat duhet të miratojë pranë këshillit të bashkisë planin social, i cili është jo vetëm një detyrim që rrjedh nga ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror

në Republikën e Shqipërisë”, por edhe një mundësi më shumë për ofrimin e shërbimeve në territor.

- ✓ Procesi i planifikimit dhe financimit të shpenzimeve për shërbimet e kujdesit shoqëror duhet të krijojë sinergji midis kërkesave të ligjit, planit social, PBA dhe buxhetit vjetor të bashkisë dhe fondeve të pushtetit qendror.
- ✓ Bashkia Berat duhet të angazhohet në projekte konkrete, për të bërë të mundur thithjen e fondeve nga fondi social dhe ai i ndërmarrjeve. Kjo gjë do të mundësojë buxhetimin me aktivitete të programeve, siç janë të moshuarit apo papunësia, si dhe qendrat sociale, për të rritur fleksibilitetin në ofrimin e shërbimeve më të shumta e më cilësore ndaj familjeve e fëmijëve vulnerabël apo edhe të moshuarve. Ajo çka vërejmë, është se bashkia pothuajse nuk kontribuon me buxhet në programet sociale, por është administruuese e fondeve të kushtëzuara.
- ✓ Bashkia nuk duhet të kufizohet vetëm në financimet e pushtetit qendror, të cilat lidhen me funksionet e përhershme të financuara, si PAK apo ndihma ekonomike. Në territorin e bashkisë Berat nuk u identifikua asnjë organizatë e cila ushtron aktivitet që ka në qendër grupet vulnerabël, apo që ofron shërbime jopublike të kujdesit shoqëror, që e bën edhe më sfidues realitetin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë bashki.
- ✓ Bashkia duhet të përdorë Fondin Social si një instrument efektiv i financimit të shërbimeve sociale.

Shtojcë 1



4. Pyetsor 1 final.docx



4. Formular 2 2 Pyetsor 1.docx



4. Formular 1 1 Pyetsor 1.docx



4. Formulari 4.docx



4. Formulari 3.docx



2. Pyetsori 2.docx

Shtojcë 2



3. Prezantim 13 maj Berat Takimi 1.pptx



2. Lista e të ftuarve.docx



1. Takim 1 Ftesa dhe Programi final 13 maj



2. Prezantim 2 qershor.pptx



1. Takimi 2 Ftesa dhe Programi 2 qershor.c



2. Prezantim 14 korrik 1. Takim 3 ftesa.docx 2026.pptx



Shtojcë 3



Shtojcë 3 Berat.docx

